



REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - PRESEDNIK

DEKRET PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE

Nr. i Dekretit: 04 /2020.

Presidenti i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 18 dhe 84 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit Nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 47, 25 janar 2009), nenit 10 (4) të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare (GZ, Nr. 28, 16 dhjetor 2011), nenit 4 (3) të Ligjit Nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 26, 02 qershor 2008), si dhe duke marrë parasysh kërkesën e Ministrisë së Punëve të Jashtme drejtuar Presidentit, me datën 09.01.2020 (Nr. Prot: 20):

D E K R E T O N

Ratifikimin e Marrëveshjes së Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit midis Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore, e nënshkruar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore, më 03.12.2019, dhe e pranuar nga Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës më 09.01.2020.

Marrëveshja e ratifikuar i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për njoftim, në përputhje me nenin 18, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.


Hashim THAÇI

President i Republikës së Kosovës

Prishtinë, më 16 . 01 .2020.

Dekreti t'i dërgohet:

- Kryetarit të Kuvendit të Kosovës;
- Ministrin të Ministrisë së Punëve të Jashtme;
- a/a

**MARRËVESHJA E PARTNERITETIT, TREGTISË DHE
BASHKËPUNIMIT MIDIS REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE
MBRETËRISË SË BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE DHE
IRLANDËS VERIORE**

Republika e KOSOVËS (“Kosova”) dhe MBRETËRIA E BASHKUAR E BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDA VERIORE (“Mbretëria e Bashkuar”) (më tej të referuara si “Palët”),

DUKE DITUR që Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, nga njëra anë, dhe Republikës së Kosovës, nga ana tjetër, e arritur në Strasburg më 27 tetor 2015 (“Marrëveshja BE-Kosovë”) do të pushojë së zbatuari në Mbretërinë e Bashkuar kur Mbretëria e Bashkuar pushon së qeni shtet anëtar i Bashkimit Evropian ose në fund të çdo marrëveshjeje kalimtare gjatë së cilës kjo Marrëveshje do të vazhdojë të zbatohet për Mbretërinë e Bashkuar;

DUKE MARRË PARASYSH parimet e përcaktuara në parathënien e Marrëveshjes BE-Kosovë, dhe duke shprehur dëshirën që të drejtat dhe detyrimet ndërmjet Palëve siç parashikohen nga Marrëveshja BE-Kosovë duhet të vazhdojnë ashtu siç janë modifikuar me këtë Marrëveshje;

KANË RËNË DAKORD SI MË POSHTË:

NENI 1

Objektivat

1. Qëllimi kryesor i kësaj Marrëveshjeje është t'i ruajë marrëdhëniet midis Palëve që janë vendosur nga lidhja e krijuar në nenin 1 të Marrëveshjes BE-Kosovë.
2. Në veçanti, Palët bien dakord t'i ruajnë kushtet preferenciale në lidhje me tregtinë midis Palëve që rezultuan nga Marrëveshja BE-Kosovë dhe të sigurojnë një platformë për liberalizimin e mëtejme të tregtisë ndërmjet Palëve.
3. Me qëllimin e eliminimit të dyshimeve, konfirmohet që Palët krijojnë një lidhje, si dhe një zonë të tregtisë së lirë të mallrave dhe rregullave të asociuara, në përputhje me këtë Marrëveshje dhe i pohojnë objektivat në nenin 1 të Marrëveshjes BE-Kosovë (siç janë modifikuar me këtë dokument ligjor).

NENI 2

Përkufizimet dhe Interpretimi

1. Përgjatë këtij dokumenti ligjor:

“Marrëveshja e Inkorporuar” nënkupton dispozitat e Marrëveshjes BE-Kosovë deri në masën e përfshirë në këtë Marrëveshje (dhe shprehjet përkatëse duhet të lexohen në përputhje me rrethanat); dhe

“*mutatis mutandis*” do të thotë me ndryshimet teknike të nevojshme për ta zbatuar Marrëveshjen BE-Kosovë, ashtu sikur të ishte lidhur në mes të Mbretërisë së Bashkuar dhe Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh objektin dhe qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Përgjatë Marrëveshjes së Inkorporuar dhe këtij dokumenti ligjor, shprehja “kjo Marrëveshje” e nënkupton marrëveshjen e plotë të cilën e përfshin ky dokument ligjor dhe dispozitat e Marrëveshjes BE-Kosovë, siç përfshihen në nenin 3.

3. Referencat ndaj bashkëpunimit financiar në Marrëveshjen e Inkorporuar përfshijnë një sërë formash të një bashkëpunimi të tillë dhe mjetet me të cilat mund të ndodhë ky bashkëpunim, përfshirë ndihmën e ofruar nga organizatat multilaterale dhe rajonale.

NENI 3

Përfshirja e Marrëveshjes BE-Kosovë

Dispozitat e Marrëveshjes BE-Kosovë në fuqi menjëherë para se të pushojnë së zbatuari në Mbretërinë e Bashkuar, janë përfshirë dhe janë bërë pjesë e kësaj Marrëveshjeje, *mutatis mutandis*, në varësi të dispozitave të këtij dokumenti ligjor.

NENI 4

Referenca ndaj ligjit të Bashkimit Evropian

1. Përveç nëse parashikohet ndryshe, referencat në këtë Marrëveshje për ligjin e Bashkimit Evropian duhet të lexohen si referenca për atë ligj të Bashkimit Evropian në fuqi siç është përfshirë ose zbatuar në ligjin e Mbretërisë së Bashkuar si ligj i Bashkimit Evropian në ditën pasi Mbretëria e Bashkuar pushon së qeni e obliguar nga ligji përkatës i Bashkimit Evropian.

2. Në këtë nen “ligji i Mbretërisë së Bashkuar” përfshin ligjin e territoreve për marrëdhëniet ndërkombëtare të së cilave është përgjegjëse Mbretëria e Bashkuar dhe ndaj të cilave aplikohet kjo Marrëveshje, siç përcaktohet në nenin 6.

NENI 5

Referenca ndaj Euros

Pavarësisht nga neni 3, referencat ndaj euros (përfshirë “EUR” dhe “€”) në Marrëveshjen e Inkorporuar do të vazhdojnë të lexohen si të tilla në këtë Marrëveshje.

NENI 6

Zbatimi Territorial

1. Me qëllimin e eliminimit të dyshimeve në lidhje me nenin e përfshirë 141, kjo Marrëveshje do të zbatohet, për sa i përket Mbretërisë së Bashkuar, deri në atë masë dhe me ato kushte të cilat Marrëveshja BE-Kosovë i zbatoi menjëherë përpara se të pushonte së zbatuari për Mbretërinë e Bashkuar, në Mbretërinë e Bashkuar dhe territoret e mëposhtme për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave është përgjegjëse:

- (a) Gjibraltari; dhe
- (b) Ishujt e Kanalit dhe Ishulli i Mani.

2. Pavarësisht nga neni 12 dhe paragrafi 1 i këtij neni 6, kjo Marrëveshje do të zbatohet për Gjibraltarin, Ishujt e Kanalit dhe Ishullin e Mani nga data e njoftimit me shkrim që Mbretëria e Bashkuar i jep Kosovës për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje në ato territore.

NENI 7

Vazhdimi i Periudhave Kalimtare të Pavarura

1. Përveç në rastet kur ky dokument ligjor parashikon ndryshe:
 - (a) nëse një periudhë kohore në Marrëveshjen BE-Kosovë nuk ka përfunduar ende, pjesa tjetër e asaj periudhe do të përfshihet në këtë Marrëveshje; dhe
 - (b) nëse një periudhë kohore në Marrëveshjen BE-Kosovë ka përfunduar, çdo e drejtë ose detyrim në vazhdim do të zbatohet ndërmjet Palëve dhe ajo periudhë nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.
2. Pavarësisht nga paragrafi 1, referenca ndaj një periudhe të caktuar në Marrëveshjen e Inkorporuar në lidhje me një procedurë ose çështje tjetër administrative (siç është rishikimi, procedura e komisionit ose njoftimi) nuk do të ndikohet.

NENI 8

Kuotat Tarifore

1. Në nenin 28 (3), Shtojcën IV dhe Shtojcën I të Protokollit 2 të Marrëveshjes së Inkorporuar, kuota tarifore ose rritja e saj do të:

(a) rivendoset në 13,62% të kuotës përkatëse ose rritjes së kuotave të referuara në Marrëveshjen BE-Kosovë, kur ajo pushon së zbatuari për Mbretërinë e Bashkuar, e rrumbullakuar në numrin e plotë më të afërt duke përdorur parimet e zakonshme aritmetike;¹ dhe

(b) të zbatohet nga Palët që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, në baza vjetore.

2. Nëse nuk parashikohet ndryshe në Marrëveshjen e Inkorporuar, periudha e administrimit për një kuotë tarifore të referuar në paragrafin 1 do të jetë nga 1 janari deri më 31 dhjetor për çdo vit që kjo Marrëveshje është në fuqi. Nëse kjo Marrëveshje hyn në fuqi pjesërisht përmes një periudhe administrimi, vëllimi i secilës kuotë tarifore do të ri-ndryshohet dhe do të zbatohet në bazë të proporcionit nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje deri më 31 Dhjetor të të njëjtit vit.

NENI 9

Dispozitat e Mëtejme Në Lidhje Me Këshillin dhe Komitetin e Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit

1. Këshilli, të cilin Palët e themelojnë sipas nenit të përfshirë 126, siguron në veçanti që kjo Marrëveshje të funksionojë siç duhet. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, Këshilli i krijuar sipas nenit të përfshirë 126 do të referohet si Këshilli i Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit dhe të gjitha referencat në Marrëveshjen e Inkorporuar (përfshirë çdo Komitet të krijuar sipas neneve 129 dhe 132) do të kuptohen në lidhje me këtë.

2. Përveç nëse Palët bien dakord ndryshe, çdo vendim i miratuar nga Këshilli i Stabilizim-Asociimit ose Komiteti i Stabilizim-Asociimit i krijuar me Marrëveshjen BE-Kosovë para se ajo të pushojë së zbatuari për Mbretërinë e Bashkuar, deri në masën që ato vendime të lidhen me Palët e kësaj Marrëveshjeje, do të konsiderohet se është miratuar, *mutatis mutandis*, dhe do t'i nënshtrohet dispozitave të këtij dokumenti ligjor, nga Këshilli i Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit ose nga

¹ Me qëllimin e eliminimit të dyshimeve, rrumbullakimi duke përdorur parimet e zakonshme aritmetike do të thotë që të gjitha shifrat të cilat kanë më pak se 50 pas pikës dhjetore do të rrumbullakohen në numrin e plotë më të afërt dhe të gjitha shifrat që kanë më shumë se 50 (të përfshirë) pas pikës dhjetore do të rrumbullakohen në numrin e plotë më të afërt.

Komiteti i Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit që Palët kanë themeluar sipas neneve 126 dhe 129 respektivisht.

3. Asgjë në paragrafin 2 nuk e ndalon Këshillin e Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit ose Komitetin e Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit të krijuar nga kjo Marrëveshje që të marrë vendime të ndryshme për t'i ndryshuar, revokuar ose shfuqizuar vendimet që konsiderohen se janë miratuar nga kjo Marrëveshje në bazë të këtij paragrafi.

NENI 10

Pjesët Përbërëse të Kësaj Marrëveshjeje

1. Shtojcat dhe fusnotat e këtij dokumenti ligjor janë pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje.
2. Asgjë në këtë nen nuk do të ndikojë në nenin 139 të Marrëveshjes së Inkorporuar, ashtu siç është ndryshuar nga kjo Marrëveshje.

NENI 11

Amendamentet

1. Palët mund të bien dakord, me shkrim, që ta ndryshojnë këtë Marrëveshje. Ndryshimi do të hyjë në fuqi pas datës së njoftimit pasues të Palëve se ato i kanë kryer procedurat e tyre të brendshme, ose në një datë për të cilën Palët mund të bien dakord.
2. Pavarësisht paragrafit 1, Këshilli i Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit mund të vendosë që Shtojcat dhe Protokollet e kësaj Marrëveshjeje të ndryshohen. Palët mund ta miratojnë vendimin e Këshillit të Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit, në varësi të kërkesave dhe procedurave të tyre ligjore në fuqi.

NENI 12

Hyrja në Fuqi

1. Neni 144 i Marrëveshjes BE-Kosovë nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.
2. Secila nga Palët do ta njoftojë palën tjetër me shkrim, përmes rrugëve diplomatike, për përfundimin e procedurave të kërkuara nga ligji i saj për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.
3. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas:

(a) datës në të cilën Marrëveshja BE-Kosovë pushon së zbatuari në Mbretërinë e Bashkuar; dhe

(b) datës së njoftimeve nga Palët ku deklarojnë që i kanë kryer procedurat e brendshme.

4. Sipas këtij neni, Mbretëria e Bashkuar do t'i dërgojë njoftime Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës ose pasuesit të saj. Sipas këtij neni, Republika e Kosovës do t'i dërgojë njoftime Zyrës për Punë të Jashtme dhe Commonwealth të Mbretërisë së Bashkuar ose pasuesit të saj.


Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar nga qeveritë e tyre përkatëse, e kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

E bërë në kopje në.....këtë.....ditë.....2019 në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe, të gjitha tekstet kanë vlerë të njëjtë autoritare.

Për Qeverinë e Republikës së Kosovës:



Për Qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës Veriore:



SHTOJCA I

Përfshirja e dispozitave të Marrëveshjes BE-Kosovë në këtë Marrëveshje ndryshohet më tej siç vijon më poshtë dhe siç përcaktohet në Shtojcat II dhe III të këtij dokumenti ligjor:

1. NDRYSHIMET E NENEVE 1 dhe 2

(a) Në nenin 1 (2) (d), fjalët “duke përfshirë përmes përafrimit të legjislacionit të saj me atë të BE-së” nuk do të përfshihen në këtë Marrëveshje.

(b) Neni 2 nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.

2. NDRYSHIMI I TITULLIT I PARIMET E PËRGJITHSHME

(a) Neni 5 do të zëvendësohet me:

“Kosova zotohet që ta vazhdojë angazhimin për përmirësim të qëndrueshëm dhe normalizim të marrëdhënieve me Serbinë. Ky zotim do të jetë bazë e zhvillimit të marrëdhënieve dhe bashkëpunimit midis Palëve.

Mbretëria e Bashkuar do të vazhdojë ta mbështesë, ashtu siç është e përshtatshme, procesin e angazhimit të përcaktuar në nenet 13 (2) dhe (3) të Marrëveshjes BE-Kosovë.

Këshilli i Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit rregullisht do ta rishikojë progresin në këtë proces dhe mund të marrë vendime dhe të nxjerrë rekomandime në lidhje me të. Komiteti i Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit mund të ndihmojë në këtë proces në përputhje me nenin 129”.

(b) Në nenin 7, fjalët “PSA. Përfundimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje bëhet brenda kornizës së PSA-së dhe bazohet në meritat e vetë Kosovës” do të zëvendësohet me fjalët “kjo Marrëveshje”.

(c) Në nenin 9, në paragrafin e dytë, fjalët “në baza vjetore” dhe “Do të jetë në përputhje me mekanizmat e krijuar nën PSA, veçanërisht raportin e progresit për PSA” nuk do të përfshihen në këtë Marrëveshje.

(d) Në nenin 9, paragrafi i pestë zëvendësohet me:

“Këshilli i Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit do ta rishikojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje në datat e dakorduara nga ai Këshill. Në bazë të këtij rishikimi, Këshilli i Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit mund të marrë vendime që e rregullojnë procesin e sigurimit të zbatimit. Nëse garantohet nga rezultatet e rishikimit, Këshilli

i Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit mund të marrë një vendim për zgjatjen e periudhës së parashikuar në paragrafin e parë jo më shumë se pesë vjet. Në mungesë të vendimeve të tilla nga Këshilli i Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit, kjo Marrëveshje do të vazhdojë të zbatohet siç është rënë dakord këtu.

3. NDRYSHIMET NË TITULLIN II DIALOGU POLITIK

- (a) Në nenin 11 (2) (b), fjalët “, bazuar në meritat individuale dhe në përputhje me zotimet e Kosovës sipas nenit 5 të kësaj Marrëveshjeje” nuk do të përfshihen në këtë Marrëveshje.
- (b) Në nenin 11 (2) (c), fjalët “konvergjencë në rritje me disa masa të Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë, veçanërisht masat kufizuese të marra nga BE” do të zëvendësohen me “bashkëpunim në disa masa të përbashkëta të politikës së jashtme dhe të sigurisë, në veçanti masa kufizuese të marra në një nivel ndërkombëtar ose rajonal”.
- (c) Neni 13 nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.
- (d) Në nenin 14 (1), fjala “kryesisht” nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje, dhe para frazës “brenda KSA-së” do të futen fjalët “midis palëve, duke përfshirë”.
- (e) Në nenin 14 (2) (c), fjalët “përfshirë ato të identifikuar në agjendën e Selanikut, të miratuara në Konkluzionet e Këshillit Evropian në Selanik më 19 dhe 20 qershor 2003” nuk do të përfshihen në këtë Marrëveshje.
- (f) Në nenin 15, fjala “do të” zëvendësohet me “mund”, dhe para fjalës “krijohen” futen fjalët “që mund të”.

4. NDRYSHIMET NË TITULLIN III BASHKËPUNIMI RAJONAL

- (a) Paragrafi i parë i nenit 16 zëvendësohet me:

“Në përputhje me zotimin e saj në bazë të nenit 5, për paqe dhe stabilitet ndërkombëtar dhe rajonal, si dhe për zhvillimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, Kosova do ta promovojë bashkëpunimin rajonal në mënyrë aktive. Mbretëria e Bashkuar mund ta ndihmojë ose ta mbështesë bashkëpunimin e tillë rajonal, si dhe atë të përcaktuar sipas neneve 17 deri 19 të Marrëveshjes BE-Kosovë.
- (b) Paragrafi i dytë dhe i tretë i nenit 16 nuk do të përfshihen në këtë Marrëveshje.
- (c) Nenet 17 deri në 19 nuk do të përfshihen në këtë Marrëveshje.

**5. NDRYSHIMET NË TITULLIN IV
LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE**

- (a) Në nenin 20 (4) (a), pjesa në vijim nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje:
- i. fjalët “, të përcaktuara në bazë të Rregullores së Këshillit (KEE) Nr. 2658/87 (1)”; dhe
 - ii. fusnota, (1).
- (b) Neni 21(2) do të zëvendësohet me:
- “Palët angazhohen për bashkëpunim të vazhdueshëm për sigurinë bërthamore, sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimi, në përputhje me parimet dhe standardet e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (ANEA) dhe traktateve dhe konventave ndërkombëtare përkatëse të përmyllura në kuadër të kornizës së ANEA”.
- (c) Pas nenit 28 (3) do të futet pjesa në vijim:
- “4. Shtojca IIA përcakton koncesione shtesë në lidhje me produktet e përfshira në Kapitujt 7 dhe 8 të Nomenklaturës së Kombinar dhe produkteve të verës”.
- (d) Në nenin 33, fjalët “jo më vonë se tre vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje” do të zëvendësohen me “brenda një afati kohor të rënë dakord nga Komiteti i Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit”.
- (e) Në nenin 41(3), fjalia e fundit nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.

**6. NDRYSHIMET NË TITULLIN V
THEMELIMI, OFRIMI I SHËRBIMEVE DHE KAPITALI**

- (a) Në nenin 53 (1), fjalia “Traktati që themelon Komunitetin e Transportit me Ballkanin Perëndimor dhe të Marrëveshjes Shumëpalëshe për vendosjen e një zone të përbashkët evropiane të aviacionit të nënshkruar më 9 qershor 2006 (1)”, do të zëvendësohet me “çdo marrëveshje ose ujdj që rregullon shërbimet e aviacionit ose transportin tokësor ndërkombëtar midis Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar”. Fusnota, (1), gjithashtu nuk do të përfshihet.
- (b) Në nenin 53 (2), fjalia “Në kuadër të politikës së transportit të BE-së”, nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.
- (c) Në nenin 58 (3), fjalia e fundit nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.

- (d) Në nenin 59 (1), fjalët “ditën para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje” zëvendësohet me “31 mars 2016”.
- (e) Në nenin 59 (2), fjalët “hyrjes në fuqi të Marrëveshjes” dhe “në ditën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes” do të zëvendësohet me “1 prill 2016”.
- (f) Në nenin 60 (1), fjalët “Marrëveshja Shumëpalëshe për Vendosjen e një Zone të Përbashkët të Aviacionit Evropian”, zëvendësohet me “një marrëveshje ose ujdë që rregullon shërbimet e aviacionit midis Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar”.
- (g) Në nenin 60 (2), fjalët “do të trajtohet nga Traktati themelues i Komunitetit të Transportit”, do të zëvendësohen me “mund të trajtohet me një marrëveshje ose ujdë që rregullon transportin rrugor ndërkombëtar midis Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar”.
- (h) Neni 60(3) nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.
- (i) Neni 62(1) nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.
- (j) Neni 66 nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.
- (k) Në nenin 68 (1), fraza “dhe *acquis* i BE-së” *acquis* i BE-së” nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.
- (l) Pas nenit 73, neni në vijim futet si nen i ri:

“ NENI 73A

1. Pavarësisht se kjo Marrëveshje nuk e zotën Kosovën që ta përafrojë legjislacionin e saj me atë të Mbretërisë së Bashkuar, Palët pranojnë se ekziston një përaftrim i legjislacionit të tyre si rezultat i Marrëveshjes BE-Kosovë në sektorët përkatës. Palët bien dakord që funksionimi i dispozitave të mëposhtme të kësaj Marrëveshjeje varet nga përaftrimi i vazhdueshëm i legjislacionit të tyre në sektorët përkatës:

Titulli V (Themelimi, Ofrimi i shërbimeve, Kapitali):

- Kapitulli I, Themelimi (Nenet 51, 52(1) dhe 55);
- Kapitulli II, Ofrimi i shërbimeve (Nenet 58 dhe 59); dhe
- Kapitulli III, Trafiku Transit (Nenet 62).

2. Nëse një Palë konsideron që niveli i nevojshëm i harmonizimit të legjislacionit të tyre nuk është arritur, ajo Palë mund të kërkojë konsultime për këtë çështje. Nëse Palët nuk bien dakord ndryshe, konsultimet sipas këtij neni do të bëhen jo më vonë

se 30 ditë nga data e dorëzimit të kërkesës për konsultime nga Pala tjetër (“data e kërkesës së konsultimit”).

3. Nëse çështja nuk zgjidhet brenda 45 ditëve nga data e kërkesës së konsultimit, një Palë mund të pezullojë funksionimin e dispozitave të përmendura në paragrafin 1 pasi të ketë njoftuar Palën tjetër në përputhje me paragrafin 4.

4. Pezullimi në paragrafin 3 nuk do të bëhet më herët se 90 ditë nga data e dorëzimit të njoftimit të përmendur në atë paragraf.

5. Në rast se një Palë pezullon dispozitat sipas paragrafit 3:

(a) Mbretëria e Bashkuar do të ofrojë shërbime dhe ofrues të shërbimeve të trajtimit për Kosovën jo më pak të favorshëm sesa ai që i jepet çdo vendi të tretë. Trajtimi preferencial i dhënë nga Mbretëria e Bashkuar për shërbimet dhe ofruesit e shërbimeve të një vendi të tretë në përputhje me GATS, përjashtohet nga ky nën-paragraf.

(b) Kosova nuk do të bëjë diskriminim për sa i përket shërbimeve dhe ofruesve të shërbimeve të Mbretërisë së Bashkuar”.

7. NDRYSHIMET NË TITULLIN VI

PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS ME ACQUIS E BE-së, ZBATIMI I LIGJIT DHE RREGULLAT E KONKURENCËS

(a) Neni 74 nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.

(b) Neni 75 (2) zëvendësohet me:

“Të gjitha praktikrat që bien në kundërshtim me këtë nen vlerësohen nga palët në përputhje me legjislacionin e tyre vendor”.

(c) Në nenin 75 (4), fjalët “në pajtueshmëri me paragrafin 2” nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

(d) Në nenin 75 (5), fjalët “duke ndjekur metodologjinë dhe paraqitjen e sondazhit të BE-së” nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

(e) Neni 75 (7) (b) nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.

(f) Neni 75 (8) (b) nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.

(g) Paragrafët e parë dhe të dytë të nenit 76 zëvendësohen me:

“Në lidhje me ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet të cilave u janë dhënë të drejta të veçanta ose ekskluzive, Palët do të sigurojnë që nuk është miratuar dhe që as nuk është nxjerrë ndonjë masë që e ndërron tregtinë midis Palëve në kundërshtim me interesat e Palëve. Kjo dispozitë nuk

duhet ta pengojë performancën në ligj ose në veprim të detyrave të veçanta të caktuara për ato ndërmarrje.”

- (h) Neni 77(2) nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.
- (i) Neni 78(1) nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.
- (j) Në nenin 79 (2), paragrafi i dytë zëvendësohet me:

“Palët do të shqyrtojnë në mënyrë periodike mundësinë e zbatimit të dispozitave të mësipërme për kontratat në sektorin e shërbimeve.”
- (k) Neni 79(7) nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.
- (l) Në nenin 79 (9), fjalia e dytë dhe e tretë nuk do të përfshihen në këtë Marrëveshje.
- (m) Neni 80(1) nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.
- (n) Në nenin 80 (2), fjalët “Për këtë qëllim” dhe pikat (a) dhe (d) nuk do të përfshihen në këtë Marrëveshje.
- (o) Në nenin 81:
 - i. në paragrafin e parë, fjalët “me qëllim të përafrimit të legjislacionit të Kosovës për mbrojtjen e konsumatorit me *acquis* e BE-së” nuk do të përfshihen në këtë Marrëveshje;
 - ii. në pikën (a), fjalët “në përputhje me ligjin e BE-së” nuk përfshihen në këtë Marrëveshje; dhe
 - iii. pika (b) do të zëvendësohet me “(b) ekziston legjislacioni adekuat për mbrojtjen e konsumatorit”.
- (p) Neni 82 nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.

8. NDRYSHIMET NË TITULLIN VII LIRIA, SIGURIA DHE DREJTËSIA

- (a) Në nenin 84, fjalia e parë zëvendësohet me:

“Palët do të bashkëpunojnë në legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave personale me qëllim të arritjes së një niveli të mbrojtjes së të dhënave personale nga Kosova që merr parasysh parimet dhe udhëzimet e organeve përkatëse ndërkombëtare për mbrojtjen e të dhënave personale.”
- (b) Neni 86 nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.

- (c) Në nenin 88:
 - i. në paragrafin e tretë, fjalët “për të filluar negociatat me qëllim të nënshkrimit të një marrëveshje që rregullon” do të zëvendësohen me “për të përcaktuar marrëveshjet që rregullojnë”; dhe
 - ii. paragrafi i fundit nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.
- (d) Në paragrafin e dytë të nenit 89, fjalët “BE-ja dhe forumet tjera” nuk do të përfshihen në këtë Marrëveshje.
- (e) Në nenin 90, fjalët “përgjatë vijave të Strategjisë kundër Drogës 2013-2020 të BE-së dhe çdo dokumenti të tij vijues” nuk do të përfshihen në këtë Marrëveshje.
- (f) Në paragrafin e dytë të nenit 91, fjalët “zbatimin e masave të cilat janë ekuivalente me ato të përcaktuara në legjislacionin përkatës të BE-së” dhe nuk do të përfshihen në këtë Marrëveshje.

9. NDRYSHIMET NË TITULLIN VIII POLITIKAT E BASHKËPUNIMIT

- (a) Në paragrafin e tretë të nenit 94, fjalët “të përafroj politikat e saj me politikat e orientuara drejt stabilitetit të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar.” nuk do të përfshihen në këtë Marrëveshje.
- (b) Në nenin 94, paragrafi i pestë nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje;
- (c) Në nenin 95, fjalët e mëposhtme nuk do të përfshihen në këtë Marrëveshje:
 - i. “në lidhje me *acquis* e BE-së”;
 - ii. “parimet e Kodit Statistikor Evropian të Praktikës, dhe”;
 - iii. “, citatat e së drejtës Statistike Evropiane, dhe duhet të zhvillohet në drejtim të zbatimit të *acquis* të BE-së në fushën e statistikave.”; dhe
 - iv. “, në mënyrë progresive të rrisin grumbullimin e të dhënave dhe transmetimin e tyre në Sistemin Statistikor Evropian,”.
- (d) Në nenin 96, fjalët “që me *acquis* e BE-së” nuk do të përfshihen në këtë Marrëveshje.
- (e) Në nenin 97, sa më poshtë nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje:

- i. në paragrafin e parë, fjalët “që lidhen me *acquis*” e BE-së” dhe “dhe praktikat e mira të BE”;
 - ii. paragrafi i dytë; dhe
 - iii. në paragrafin e tretë, fjalët “dhe praktika e mirë e BE-së”.
- (f) Në nenin 99, paragrafi i fundit nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.
- (g) Në nenin 100, fjalia e fundit nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.
- (h) Në paragrafin e dytë të nenit 101, fjalët “Bashkëpunimi do të marrë në konsideratë pjesën e duhur nga *acquis* i BE-së në fushën e turizmit.” nuk do të përfshihen në këtë Marrëveshje.
- (i) Në nenin 102, fjalët e mëposhtme nuk përfshihen në këtë Marrëveshje:
 - i. “Në të gjitha fushat prioritare që lidhen me *acquis* të BE-së”;
 - ii. “posaçërisht që të arrij kërkesat sanitare të BE-së”; dhe
 - iii. “atë mbështesë përafrimin gradual të legjislacionit dhe praktikave të Kosovës me *acquis*” të BE-së.
- (j) Në nenin 103, fjalët “fushat prioritare që lidhen me *acquis* të BE-së në këto fusha, dhe” nuk do të përfshihen në këtë Marrëveshje.
- (k) Në nenin 104, pjesa në vijim nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje:
 - i. në paragrafin e parë, fjalët “dhe përafrimin e sistemit doganor të Kosovës me atë të BE-së” dhe “për të arritur përafrimin gradual të legjislacionit të Kosovës për doganat me atë të *acquis* të BE-së”; dhe
 - ii. paragrafi i dytë.
- (l) Në paragrafin e dytë të nenit 105, fjalët “që lidhen me *acquis* të BE-së” dhe fjalia e dytë, e cila fillon “Kosova me rastin e përgatitjes...”, nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.
- (m) Në nenin 106, pjesa në vijim nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje:
 - i. në paragrafin e parë, fjalët “si dhe përafrimin gradual ligjor të legjislacionit të Kosovës me *acquis* të BE-së për punën, shëndetin, sigurinë në punë dhe mundësi të barabarta për gratë dhe burrat, për personat me aftësi të kufizuara dhe për personat që i përkasin grupeve minoritare dhe grupeve të tjera të cenueshme, duke iu referuar nivelit ekzistues të mbrojtjes në BE. Kjo mund të përfshijë

përafrimin e Kosovës me *acquis* të BE-së në fushën e ligjit të punës dhe në lidhje me kushtet e punës për gratë”; dhe

- ii. në paragrafin e dytë, fjalët “me qëllim që të sigurojnë përafrimin e legjislacionit të Kosovës me *acquis* të BE-së”; dhe
 - iii. në paragrafin e tretë, fjalinë e fundit.
- (n) Në nenin 107, paragrafët e katërt dhe të pestë nuk do të përfshihen në këtë Marrëveshje.
 - (o) Në paragrafin e fundit të nenit 109, fjalia e parë nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.
 - (p) Në nenin 110, paragrafi i parë nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.
 - (q) Në nenin 111, pjesa në vijim nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje:
 - i. paragrafi i parë; dhe
 - ii. në paragrafin e dytë, fjalët “me objektivin përfundimtar të miratimit nga Kosova të *acquis* të BE-së në sektor pesë vite pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.”.
 - (r) Neni 113 nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.
 - (s) Në Nenin 114, fjalët “Në përputhje me *acquis* përkatës të BE-së” dhe “dhe të Traktatit themelues të Komunitetit të Energjisë, i nënshkruar në Athinë më 25 tetor të vitit 2005” nuk do të përfshihen në këtë Marrëveshje.
 - (t) Në nenin 114(a), fjalët “në përputhje me *acquis* të BE-së mbi sigurinë e furnizimit dhe të strategjisë rajonale të energjisë të Komunitetit të Energjisë”, dhe “BE-së dhe” nuk do të përfshihen në këtë Marrëveshje.
 - (u) Në Nenin 114 (b), fjalët “të zbatojë *acquis* të BE-së për efikasitetin e energjisë, burimeve të ripërtëritshme të energjisë si dhe ndikimit mjedisor nga sektori i energjisë”, zëvendësohen me “të ngritë efikasitetin e energjisë, burimet e rinovueshme të energjisë dhe vlerësojë dhe zvogëlojë ndikimin mjedisor të sektorit të energjisë”.
 - (v) Në nenin 114 (c), fjalët “në përputhje me rregullat e tregut të brendshëm të energjisë të BE-së për shturjen” nuk do të përfshihen në këtë Marrëveshje.
 - (w) Në paragrafin e dytë të nenit 115, fjalët “dhe do të përqendrohet në përafrimin gradual të legjislacionit të Kosovës me *acquis* të BE-së dhe

është e përshtatshme me *acquis* të Euratom” nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.

- (x) Në Nenin 116, fjalët “përafrimin gradual të legjislacionit të Kosovës me *acquis* të BE-së mbi ndryshimin klimatik, në veçanti” nuk do të përfshihen në këtë Marrëveshje.
- (y) Në paragrafin e parë të nenit 117, fjalët “dhe në përafrimin gradual të Kosovës me *acquis* të BE-së lidhur me menaxhimin e katastrofave” nuk do të përfshihen në këtë Marrëveshje.
- (z) Në nenin 117 (a), fjalët “mbulimi i Kosovës nga sistemet e paralajmërimit të hershëm dhe nga mjete monitoruese Evropiane” nuk do të përfshihen në këtë Marrëveshje.
- (aa) Paragrafi i dytë i nenit 118 nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.
- (bb) Paragrafi i dytë i nenit 119 nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.

10. NDRYSHIMET NË TITULLIN IX BASHKËPUNIMI FINANCIAR

- (a) Në nenin 121, fjalët “nenet 7, 122 dhe 123 dhe 125” zëvendësohen me “nenin 7”.
- (b) Në nenin 121, fjalët “nga BE-ja në formë grantesh dhe huash” deri në fund të këtij neni, zëvendësohen me “nga Mbretëria e Bashkuar që i nënshtrohen marrëveshjes së të dyja palëve. Mbretëria e Bashkuar gjithashtu mund të bashkëpunojë me nismat e përcaktuara në nenet 121 deri 125 të Marrëveshjes BE-Kosovë, në varësi të marrëveshjes së të gjitha palëve”.
- (c) Nenet 122 deri 125 nuk do të përfshihen në këtë Marrëveshje.

11. NDRYSHIMET NË TITULLIN X DISPOZITAT INSTITUCIONALE, TË PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

- (a) Neni 127(5) nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.
- (b) Në paragrafin e parë dhe të dytë të nenit 130, në secilin rast, pas “do të” futen fjalët “aty ku është e përshtatshme”.
- (c) Në paragrafin e parë të nenit 132:
 - i. fjalët “me këtë” zëvendësohen me “mund të”; dhe
 - ii. pas “themelohet” shtohen fjalët “nga palët”.

- (d) Në nenin 136 (6) fjalët “nenet 5 dhe 13” zëvendësohen me “neni 5”.
- (e) Neni 139 zëvendësohet me:
“Shtojcat I deri VII dhe Protokollet I, II, III, IV dhe V do të përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.”
- (f) Paragrafi i fundit i nenit 140 nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.
- (g) Në nenin 141, fjalët “, Traktati mbi Funksonimin e Bashkimit Evropian dhe Traktati Themelues i Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike” do të zëvendësohen me “dhe Traktatin mbi Funksonimin e Bashkimit Evropian”.
- (h) Neni 142 nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.
- (i) Neni 143 nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.

**12. NDRYSHIMET NË PROTOKOLLIN II
KONCESIONET RECIPROKE PREFERENCIALE PËR VERËRAT E
CAKTUARA, NJOHJA, MBROJTJA DHE KONTROLLI RECIPROK I
EMRAVE TË VERËRAVE, PIJEVE ALKOOLIKE DHE VERËRAVE TË
AROMATIZUARA**

- (a) Në fund të nenit 2 (1), Shtojca II, si fusnotë futet pjesa si vijon:
“Emërtimet *Uiski Irlandez, Uisce Beatha Eireannach, Uiski Irlandez* dhe *Krem Irlandez*, të listuara në Shtojcën 1, Pjesa A, përfshijnë pijet alkoolike të prodhuara në Republikën e Irlandës dhe Irlandën Veriore”.
 - (b) Në nenin 11 (2), Shtojca II, fjalia e dytë zëvendësohet me:
“Mbretëria e Bashkuar cakton Departamentin për Mjedis, Ushqim dhe Çështje Rurale si organin e tij përfaqësues”.
 - (c) Në Shtojcën 1, Aneksi II, Pjesët A (a) dhe (c), treguesit gjeografik në lidhje me pjesë të Bashkimit Evropian që nuk janë Mbretëria e Bashkuar nuk do të përfshihen në këtë Marrëveshje.
 - (d) Në Aneksin II, Shtojca 1, Pjesa A (b) do të zëvendësohet me:
“(b) PIJE ALKOOLIKE ME ORIGJINË NGA MBRETËRIA E BASHKUAR
- 1. (a) Uiski**
Uiski skocez
Uiski Irlandez
(Këto emërtime mund të plotësohen me termat “malt” ose “drithë”)

(b) Uiski

Uiski Irlandez

Uisce Beatha Eireannach/Uiski Irlandez

(Këto përcaktime mund të plotësohen me termat “pot still”)

2. Liker

Krem Irlandez

3. Verë molle dhe raki dardhe

Somerset Cider Brandy

4. Pije tjera alkoolike

Irish Poteen/Irish Poitín”

(e) Në Shtojcën 2, Aneksi II, shprehjet tradicionale në lidhje me pjesë të Bashkimit Evropian që nuk janë Mbretëri e Bashkuar nuk do të përfshihen në këtë Marrëveshje.

(f) Në Aneksin II, Shtojca 3, paragrafi (b) do të zëvendësohet me:

“Mbretëria e Bashkuar do të njoftojë Kosovën për pikën e saj të kontaktit pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.”

13. NDRYSHIMET NË PROTOKOLLIN IV

**ASISTENCA RECIPROKE ADMINISTRATIVE NË ÇËSHTJET
DOGANORE**

(a) Në nenin 13 (1), fjalët “shërbimeve kompetente të Komisionit Evropian dhe” nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

(b) Në nenin 14 (1), fjalët “Duke marrë parasysh kompetencat përkatëse të BE-së dhe të Shteteve Anëtare”, nuk do të përfshihen në këtë Marrëveshje.

(c) Neni 14 (1) (c) nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.

(d) Neni 14 (2) zëvendësohet me:

“Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, dispozitat e këtij Protokoll do të kenë përparësi ndaj dispozitave të çdo Marrëveshjeje bilaterale për asistencën reciproke që është lidhur midis Mbretërisë së Bashkuar dhe Kosovës para datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje përderisa dispozitat e kësaj të fundit nuk janë në përputhje me ato të këtij Protokoll.”

**14 NDRYSHIMET NË PROTOKOLLIN V
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

- (a) Në pikën e pestë të nenit 2 (b), pas “deri 73” futen fjalët “, por jo, me qëllimin e eliminimit të dyshimeve, neni 73A”.
- (b) Në nenin 2 (c), fjalët “Nenet 78 (1) (aspektet që lidhen me tregtinë e pronës intelektuale) dhe” nuk do të përfshihen në këtë Marrëveshje.
- (c) Në nenin 13, fjalia e dytë dhe e tretë nuk do të përfshihen në këtë Marrëveshje.
- (d) Në nenin 15 (2), fjalia e parë zëvendësohet me:

“Arbitrat duhet të kenë njohuri të specializuara dhe përvojë me ligjin, përfshirë të drejtën ndërkombëtare dhe tregtinë ndërkombëtare.”

15. DEKLARATA E PËRBASHKËT

- (a) Deklarata e Përbashkët nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.

ANEKSI II

- (a) Protokoli III do të zëvendësohet me:

TITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

NENI 1

Përkufizimet

Për qëllimet e këtij Protokoli:

- (a) “prodhimi” do të thotë çdo lloj pune ose përpunimi, përfshirë montimin ose operacionet specifike;
- (b) “materiali” do të thotë çdo përbërës, lëndë e parë, komponent ose pjesë etj. e përdorur në prodhimin e një produkti;
- (c) “produkti” do të thotë një produkt që prodhohet, edhe nëse është i destinuar për përdorim të mëvonshëm në një operacion tjetër prodhues;
- (d) “mallrat” përfshijnë si materialet ashtu edhe produktet;
- (e) “vlera doganore” do të thotë vlera e përcaktuar në përputhje me Marrëveshjen për zbatimin e nenit VII të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë 1994;
- (f) “çmimi i punimeve me kosto direkte” nënkupton çmimin e paguar me kosto direkte për produktin e prodhuesit në Mbretërinë e Bashkuar ose në Kosovë në prodhimin e të cilit është kryer punimi ose përpunimi i fundit, me kusht që çmimi të përfshijë vlerën e të gjitha materialeve të përdorura, duke zbritur taksat e brendshme të cilat paguhën ose mund të paguhën kur produkti i prodhuar eksportohet;
- (g) “vlera e materialeve” do të thotë vlera doganore në kohën e importimit të materialeve joorigjinuese të përdorura, ose, nëse kjo nuk dihet dhe nuk mund të konstatohet, çmimi i parë i konstatueshëm i paguar për materialet në Mbretërinë e Bashkuar ose në Kosovë;
- (h) “vlera e materialeve origjinuese” nënkupton vlerën e materialeve të atilla siç përcaktohen në (g) të aplikuara *mutatis mutandis*;

- (i) “vlera e shtuar” nënkupton çmimin e punimeve me kosto direkte duke zbritur vlerën doganore të secilit prej materialeve të përfshira të cilat kanë origjinën në vendet e tjera të përmendura në nenet 3 dhe 4 me të cilat zbatohet kumulimi ose, kur vlera doganore nuk dihet ose nuk mund konstatohet, çmimi i parë i konstatueshëm i paguar për materialet në Mbretërinë e Bashkuar ose në Kosovë;
- (j) ‘kapitujt’ dhe ‘titujt’ nënkuptojnë kapitujt dhe titujt (kodet katërshifrore) të përdorura në nomenklaturë që përbëjnë Sistemin e Harmonizuar të Përshkrimit dhe Kodimit të Mallrave, i cili në këtë Protokoll referohet si ‘Sistemi i Harmonizuar’ ose ‘HS’;
- (k) ‘i klasifikuar’ i referohet klasifikimit të një produkti ose materiali nën një titull të veçantë;
- (l) “dërgesa” ka të bëjë me produkte që dërgohen njëkohësisht nga një eksportues tek një marrës i dërgesës ose mbulohen nga një dokument i vetëm transporti që mbulon dërgesën e tyre nga eksportuesi tek marrësi ose, në mungesë të një dokumenti të tillë, nga një faturë e vetme;
- (m) “territoret” përfshijnë ujërat territoriale;
- (n) “Shtojcat e Inkorporuara I deri IV b” nënkuptojnë Shtojcat I deri IV b të Shtojcës I të Konventës Rajonale mbi rregullat preferenciale pan-Euro-Mesdhetare të origjinës, pasi ato shtojca inkorporohen në nenin 40 të këtij Protokoll.

TITULLI II

PËRKUFIZIMI I KONCEPTIT TË “PRODUKTEVE ORIGJINUESE”

NENI 2

Kërkesat e Përgjithshme

1. Për qëllimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, produktet e mëposhtme do të konsiderohen si me origjinë nga Mbretëria e Bashkuar:
 - (a) produkte të prodhuara tërësisht në Mbretërinë e Bashkuar brenda kuptimit të nenit 5;
 - (b) produkte të prodhuara në Mbretërinë e Bashkuar që përfshijnë materiale që nuk janë prodhuar tërësisht atje, me kusht që materialet e tilla të kenë kaluar një përpunim të mjaftueshëm në Mbretërinë e Bashkuar brenda kuptimit të nenit 6.

2. Për qëllim të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, produktet e mëposhtme do të konsiderohen si me origjinë nga Kosova:

- (a) produkte të prodhuara tërësisht në Kosovë brenda kuptimit të nenit 5;
- (b) produkte të prodhuara në Kosovë që përfshijnë materiale që nuk janë prodhuar tërësisht atje, me kusht që materiale të tilla të kenë kaluar një përpunim të mjaftueshëm në Kosovë brenda kuptimit të nenit 6.

NENI 3

Kumulimi në Mbretërinë e Bashkuar

1. Pa cenuar dispozitat e nenit 2 (1), produktet do të konsiderohen si me origjinë nga Mbretëria e Bashkuar, nëse ato janë prodhuar atje, duke përfshirë materiale me origjinë nga Zvicra (përfshirë Lihtenshtajnin)², Islanda, Norvegjia, Turqia ose Bashkimi Evropian, me kusht që puna ose përpunimi i kryer në Mbretërinë e Bashkuar të shkojë përtej operacioneve të përmendura në nenin 7. Nuk do të jetë e nevojshme që materialet e tilla të kenë kaluar një përpunim të mjaftueshëm.

2. Pa cenuar dispozitat e nenit 2(1), produktet do të konsiderohen si me origjinë nga Mbretëria e Bashkuar nëse ato janë prodhuar atje, duke përfshirë materiale me origjinë nga Kosova ose ndonjë vend tjetër i referuar në Shtojcën A të këtij Protokollit, me kusht që puna ose përpunimi i kryer në Mbretërinë e Bashkuar të shkojë përtej operacioneve të përmendura në nenin 7. Nuk do të jetë e nevojshme që materialet e tilla të kenë kaluar një përpunim të mjaftueshëm.

3. Pa cenuar dispozitat e nenit 2 (1), përpunimi i kryer në Islandë, Norvegji ose në Bashkimin Evropian, do të konsiderohet se është kryer në Mbretërinë e Bashkuar kur produktet e prodhuara t'i nënshtrohen përpunimit të mëtejshëm në Mbretërinë e Bashkuar, përpunim ky që tejkalon operacionet e përmendura në nenin 7.

4. Për kumulimin e parashikuar në paragrafët 1 dhe 2, ku puna ose përpunimi i kryer në Mbretërinë e Bashkuar nuk tejkalon operacionet e përmendura në nenin 7, produkti i prodhuar do të konsiderohet si me origjinë në Mbretërinë e Bashkuar vetëm kur vlera e shtuar atje është më e madhe se vlera e materialeve të përdorura që kanë origjinë nga ndonjë prej vendeve të tjera. Nëse nuk është kështu, produkti i prodhuar do të konsiderohet si me origjinë nga vendi që ka vlerën më të lartë të materialeve origjinuese të përdorura në prodhim në Mbretërinë e Bashkuar.

5. Për kumulimin e parashikuar në paragrafin 3, kur puna ose përpunimi i kryer në Mbretërinë e Bashkuar nuk tejkalon operacionin e përmendur në nenin 7, produkti i prodhuar do të konsiderohet si me origjinë nga Mbretëria e Bashkuar vetëm kur vlera e shtuar atje është më e madhe sesa vlera e shtuar në ndonjë prej vendeve të tjera.

² Për shkak të Traktatit Doganor ndërmjet Lihtenshtajnit dhe Zvicrës, produktet me origjinë nga Lihtenshtajni konsiderohen si me origjinë nga Zvicra.

6. Produktet me origjinë nga vendet e përmendura në paragrafët 1 dhe 2, të cilat nuk i nënshtrohen asnjë përpunimi në Mbretërinë e Bashkuar ruajnë origjinën e tyre nëse eksportohen në një nga këto vende.

7. (a) Kumulimi i parashikuar në këtë nen në lidhje me Bashkimin Evropian mund të zbatohet me kusht që:

- i. Mbretëria e Bashkuar, Kosova dhe Bashkimi Evropian të kenë marrëveshje për bashkëpunimin administrativ që sigurojnë një zbatim të saktë të këtij neni;
- ii. materialet dhe produktet të kenë fituar statusin e origjinës me zbatimin e rregullave të origjinës identike me ato të këtij Protokolli; dhe
- iii. njoftimet që tregojnë përmbushjen e kërkesave të nevojshme për të aplikuar kumulimin të jenë publikuar nga Palët.

(b) Me përjashtim të dispozitave të parashikuara në paragrafin 7 (a), kumulimi i parashikuar me këtë nen mund të zbatohet me kusht që:

- i. një marrëveshje tregtare preferenciale në përputhje me nenin XXIV të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë 1994 ("MPTT 1994") të jetë e zbatueshme midis vendeve të përfshira në marrjen e statusit të origjinës dhe vendit të destinacionit;
- ii. materialet dhe produktet të kenë fituar statusin e origjinës me zbatimin e rregullave të origjinës identike me ato të këtij Protokolli; dhe
- iii. njoftimet që tregojnë përmbushjen e kërkesave të nevojshme për të aplikuar kumulimin të jenë publikuar nga Palët.

8. Mbretëria e Bashkuar do t'i ofrojë Kosovës detaje për marrëveshjet ose planet, përfshirë datat e hyrjes së tyre në fuqi, dhe rregullat përkatëse të origjinës, të cilat zbatohen me vendet e tjera të përmendura në paragrafët 1 dhe 2.

NENI 4

Kumulimi në Kosovë

1. Pa cenuar dispozitat e nenit 2 (2), produktet do të konsiderohen si me origjinë nga Kosova, nëse ato janë prodhuar atje, duke përfshirë materiale me origjinë nga Mbretëria e Bashkuar, Zvicra (përfshirë Lihtenshtajnin), Islanda, Norvegjia, Turqia ose Bashkimi Evropian, me kusht që puna ose përpunimi i kryer në Kosovë të shkojë

përtej operacioneve të përmendura në nenin 7. Nuk do të jetë e nevojshme që materialet e tilla të kenë kaluar një përpunim të mjaftueshëm.

2. Pa cenuar dispozitat e nenit 2 (2), produktet do të konsiderohen si me origjinë nga Kosova nëse ato janë prodhuar atje, duke përfshirë materiale me origjinë nga çdo vend i përmendur në Shtojcën A të këtij Protokolli, me kusht që puna ose përpunimi i kryer në Kosovë të shkojë përtej operacioneve të përmendura në nenin 7. Nuk do të jetë e nevojshme që materialet e tilla të kenë kaluar një përpunim të mjaftueshëm.

3. Kur puna ose përpunimi i kryer në Kosovë nuk tejkalon operacionet e përmendura në nenin 7, produkti i prodhuar do të konsiderohet si me origjinë nga Kosova vetëm kur vlera e shtuar atje është më e madhe se vlera e materialeve të përdorura që kanë origjinë nga cilindo nga vendet e tjera të përmendura në paragrafët 1 dhe 2. Nëse nuk është kështu, produkti i prodhuar do të konsiderohet si me origjinë nga vendi që ka vlerën më të lartë të materialeve origjinuese të përdorura në prodhim në Kosovë.

4. Produktet me origjinë nga vendet e përmendura në paragrafët 1 dhe 2, të cilat nuk i nënshtrohen asnjë përpunimi në Kosovë, ruajnë origjinën e tyre nëse eksportohen në njërën prej këtyre vendeve.

5. (a) Kumulimi i parashikuar në këtë nen në lidhje me Bashkimin Evropian mund të zbatohet me kusht që:

- i. Mbretëria e Bashkuar, Kosova dhe Bashkimi Evropian të kenë marrëveshje për bashkëpunimin administrativ që sigurojnë një zbatim të saktë të këtij neni;
- ii. materialet dhe produktet të kenë fituar statusin e origjinës me zbatimin e rregullave të origjinës identike me ato të këtij Protokolli; dhe
- iii. njoftimet që tregojnë përmbushjen e kërkesave të nevojshme për të aplikuar kumulimin të jenë publikuar nga Palët.

(b) Me përjashtim të dispozitave të parashikuara në paragrafin 5 (a), kumulimi i parashikuar me këtë nen mund të zbatohet me kusht që:

- i. një marrëveshje tregtare preferenciale në përputhje me nenin XXIV të MPTT 1994 është e zbatueshme midis vendeve të përfshira në marrjen e statusit të origjinës dhe vendit të destinacionit;
- ii. materialet dhe produktet të kenë fituar statusin e origjinës me zbatimin e rregullave të origjinës identike me ato të këtij Protokolli; dhe

- iii. njoftimet që tregojnë përmbushjen e kërkesave të nevojshme për të aplikuar kumulimin të jenë publikuar nga Palët.

6. Kosova do t'i ofrojë Mbretërisë së Bashkuar detaje mbi marrëveshjet ose planet, përfshirë datat e hyrjes së tyre në fuqi, dhe rregullat e tyre përkatëse të origjinës, të cilat zbatohen me vendet e tjera të përmendura në paragrafët 1 dhe 2.

NENI 5

Produktet Tërësisht të Prodhuara

1. Produktet e mëposhtme do të konsiderohen si të prodhuara tërësisht në Mbretërinë e Bashkuar ose Kosovë:

- (a) produkte minerale të nxjerra nga toka e saj ose nga shtrati i detit të saj;
- (b) produkte bimore të korrura atje;
- (c) kafshë të gjalla të lindura dhe rritura atje;
- (d) produkte nga kafshë të gjalla të rritura atje;
- (e) produkte të përfituara nga gjuetia ose peshkimi i kryer atje;
- (f) produkte të peshkimit detar dhe produkte të tjera të marra nga deti jashtë ujërave territoriale të Palës nga anijet e saj;
- (g) produkte të prodhuara ekskluzivisht nga produktet e përmendura në (f) në bordin e anijeve-fabrikë të saj;
- (h) artikujt e përdorur të grumbulluar atje përshtaten vetëm për rikuperimin e lëndëve të para, përfshirë gomat e përdorura të përshtatshme vetëm për ritregim ose për përdorim si mbeturina;
- (i) mbeturinat dhe mbetjet që vijnë nga operacionet prodhuese të kryera atje;
- (j) produkte të nxjerra nga toka ose nëntoka detare jashtë ujërave të saj territoriale me kusht që të ketë të drejta të vetme për të punuar atë tokë ose nëntokë;
- (k) mallrat e prodhuara atje ekskluzivisht nga produktet e specifikuar nga (a) deri në (j).

2. Termet “anijet e saj” dhe “anijet-fabrikë të saj” në paragrafët 1 (f) dhe (g) do të zbatohen vetëm për anijet dhe anijet-fabrikë:

- (a) të cilat janë regjistruar në Mbretërinë e Bashkuar ose Kosovë;

- (b) që lundrojnë nën flamurin e Mbretërisë së Bashkuar ose të Kosovës;
- (c) të cilat janë në pronësi deri në një masë prej të paktën 50% nga shtetas të Mbretërisë së Bashkuar, një Shtet Anëtar i Bashkimit Evropian ose i Kosovës, ose nga një kompani me selinë e saj në një prej këtyre Shteteve, nga të cilat menaxheri ose menaxherët, Kryetari të Bordit të Drejtorëve ose Bordit Mbikëqyrës, dhe shumica e anëtarëve të bordeve të tilla janë shtetas të Mbretërisë së Bashkuar, të një Shteti Anëtar të Bashkimit Evropian ose të Kosovës dhe nga të cilët, përveç kësaj, në rast partneriteti ose kompanive aksionare, të paktën gjysma e kapitalit u përket atyre Shteteve ose organeve publike ose shtetasve të Shteteve në fjalë;
- (d) nga të cilët pronari dhe zyrtarët janë shtetas të Mbretërisë së Bashkuar, të një Shteti Anëtar të Bashkimit Evropian ose të Kosovës; dhe
- (e) prej të cilave të paktën 75% e ekuipazhit janë shtetas të Mbretërisë së Bashkuar, të një Shteti Anëtar të Bashkimit Evropian ose të Kosovës.

NENI 6

Produktet e Punuara ose të Përpunuara në Mënyrë të Mjaftueshme

1. Për qëllimet e nenit 2, produktet të cilat nuk janë prodhuar tërësisht, konsiderohen se janë punuar ose përpunuar në mënyrë të mjaftueshme kur plotësohen kushtet e përcaktuara në listën e Shtojcës II të përfshirë.

Kushtet e përmendura më lart tregojnë punën ose përpunimin i cili duhet të kryhet në materiale jo-origjinuese të përdorura në prodhim dhe aplikohen vetëm në lidhje me materiale të tilla. Nga kjo rrjedh se nëse një produkt i cili ka fituar statusin e origjinës duke përmbushur kushtet e përcaktuara në listë përdoret në prodhimin e një produkti tjetër, kushtet e zbatueshme për produktin në të cilin është përfshirë nuk zbatohen për të, dhe asnjë llogari nuk duhet të merret nga materialet jo-origjinuese të cilat mund të jenë përdorur në prodhimin e tij.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1, materialet joorigjinuese, të cilat, sipas kushteve të përcaktuara në listë në Shtojcën II të përfshirë, nuk duhet të përdoren në prodhimin e një produkti, megjithatë mund të përdoren, me kusht që:

- (a) vlera e tyre totale nuk kalon 10% të çmimit të punimeve me kosto direkte të produktit;
- (b) ndonjëra prej përqindjeve të dhëna në listë për vlerën maksimale të materialeve jo-origjinuese nuk tejkalohet në bazë të këtij paragrafi.

Ky paragraf nuk do të zbatohet për produktet që janë në kapitujt 50 deri 63 të Sistemit të Harmonizuar.

3. Paragrafët 1 dhe 2 do të zbatohen në varësi të dispozitave të nenit 7.

NENI 7

Puna ose Përpunimi i Pamjaftueshëm

1. Pa cenuar paragrafin 2, veprimet e mëposhtme konsiderohen si punë ose përpunime të pamjaftueshme për t'u dhënë statusin e produkteve origjinuese, pavarësisht nëse kërkesat e nenit 6 janë përmbushur ose jo:

- (a) Ruajtja për të siguruar që produktet të mbeten në gjendje të mirë gjatë transportit dhe magazinimit;
- (b) prishja dhe grumbullimi i ambalazheve;
- (c) larja, pastrimi; heqja e pluhurit, oksidimit, vajit, ngjyrës ose shtresave të tjera;
- (d) hekurosja ose shtypja e tekstileve;
- (e) operacione të thjeshta të ngjyrosjes dhe lustrimit;
- (f) heqja e lëvozhgave, zbardhimi i pjeshëm ose i plotë, lustrimi i drithërave dhe orizit;
- (g) operacionet për ngjyrosjen e sheqerit ose formimin e gungave të sheqerit;
- (h) qërimi, heqja e gëzhjojave, të frutave, arrave dhe perimeve;
- (i) mprehja, bluarja e thjeshtë ose prerja e thjeshtë;
- (j) shoshitja, renditja, klasifikimi, gradimi, përputhja (përfshirë krijimin e grupeve të artikujve);
- (k) vendosja e thjeshtë në shishe, kanaçe, çanta, kasa, kuti, vendosja në kartonë ose dërrasa dhe të gjitha operacionet e tjera të thjeshta të paketimit;
- (l) vendosja ose shtypja e markave, etiketave, logove dhe shenjave të tjera dalluese në produkte ose në paketimin e tyre;
- (m) përzierja e thjeshtë e produkteve, qoftë ajo e llojeve të ndryshme apo jo;
- (n) përzierja e sheqerit me ndonjë material;
- (o) montimi i thjeshtë i pjesëve të artikujve për të bërë një artikull të plotë ose çmontimi i produkteve në pjesë;

- (p) kombinimi i dy ose më shumë operacioneve të specifikuara në (a) deri (n);
- (q) therja e kafshëve.

2. Të gjitha operacionet e kryera në Mbretërinë e Bashkuar ose në Kosovë mbi një produkt të caktuar do të konsiderohen së bashku kur përcaktohet nëse punimi ose përpunimi i atij produkti duhet të konsiderohet i pamjaftueshëm brenda kuptimit të paragrafit 1.

NENI 8

Njësia e Kualifikimit

1. Njësia e kualifikimit për zbatimin e dispozitave të këtij Protokollit do të jetë produkti i veçantë që konsiderohet si njësia themelore kur përcaktohet klasifikimi duke përdorur nomenklaturën e Sistemit të Harmonizuar.

Nga kjo rrjedh se:

- (a) kur një produkt i përbërë nga një grup ose kombinim artikujsh klasifikohet sipas kushteve të Sistemit të Harmonizuar në një titull të vetëm, njësia përbën njësinë e kualifikimit;
- (b) kur një dërgesë përbëhet nga një numër i produkteve identike të klasifikuara nën të njëjtin titull të Sistemit të Harmonizuar, secili produkt duhet të konsiderohet individualisht kur zbatohen dispozitat e këtij Protokollit.

2. Kur, sipas rregullit të përgjithshëm 5 të Sistemit të Harmonizuar, paketimi përfshihet me produktin për qëllime klasifikimi, ai përfshihet për qëllime të përcaktimit të origjinës.

NENI 9

Pajisjet Shtesë, Pjesët Rezervë dhe Mjetet

Pajisjet shtesë, pjesët rezervë dhe mjetet e dërguara me një pjesë të pajisjeve, makinerisë, aparateve ose automjeteve, të cilat janë pjesë e pajisjeve normale dhe të përfshira në çmimin e tyre ose që nuk janë të faturuara veçmas, do të konsiderohen si një me pjesën e pajisjeve, makinerisë, aparateve ose automjeteve në fjalë.

NENI 10

Kompletet (Setet)

Kompletet (setet), siç përcaktohet në rregullin e përgjithshëm 3 të Sistemit të Harmonizuar, do të konsiderohen si origjinuese kur të gjitha produktet përbërëse janë origjinuese. Sidoqoftë, kur një komplet (set) përbëhet nga produkte origjinuese dhe joorigjinuese, kompleti (seti) në tërësi do të konsiderohet si origjinues, me kusht që vlera e produkteve joorigjinuese të mos kalojë 15% të çmimit të punimeve me kosto direkte të kompletit.

NENI 11

Elementet Neutrale

Për të përcaktuar nëse një produkt është produkt origjinues, nuk do të jetë e nevojshme të përcaktohet origjina e elementeve të mëposhtme që mund të përdoren në prodhimin e saj:

- (a) energjia dhe karburanti;
- (b) fabrika dhe pajisjet;
- (c) makineritë dhe mjetet;
- (d) mallrat të cilat as nuk hyjnë në përbërjen përfundimtare të produktit dhe as nuk synohet të hyjnë.

TITULLI III

KËRKESAT TERRITORIALE

NENI 12

Parimi i Territorialitetit

1. Me përjashtim të dispozitave të parashikuara në nenet 3, 4 dhe paragrafit 3 të këtij neni, kushtet për marrjen e statusit të origjinës të përcaktuara në Titullin II duhet të përmbushen pa ndërprerje në Mbretërinë e Bashkuar, ose në Kosovë.
2. Me përjashtim të dispozitave të parashikuara në nenet 3 dhe 4, kur mallrat origjinuese të eksportuara nga Mbretëria e Bashkuar ose nga Kosova në një vend tjetër kthehen, ato konsiderohen si jo origjinuese, përveç nëse mund të dëshmohet tek autoritetet doganore që:

- (a) mallrat e kthimit janë të njëjta me ato të eksportuara; dhe
- (b) ato nuk i janë nënshtruar asnjë operacioni përtej asaj që është e nevojshme për t'i ruajtur ato në gjendje të mirë gjatë qëndrimit në atë vend ose gjatë eksportimit.

3. Marrja e statusit të origjinës në përputhje me kushtet e përcaktuara në Titullin II nuk do të ndikohet nga puna ose përpunimi i bërë jashtë Mbretërisë së Bashkuar ose Kosovës në materialet e eksportuara nga Mbretëria e Bashkuar ose Kosova dhe më pas të ri-importuara atje, me kusht që:

- (a) materialet në fjalë janë tërësisht të prodhuara në Mbretërinë e Bashkuar ose Kosovë ose janë përpunuar përtej operacioneve të përmendura në nenin 7 para se të eksportohen; dhe
- (b) mund të tregohet tek autoritetet doganore që:
 - (i) mallrat e ri-importuara janë prodhuar duke punuar ose përpunuar materialet e eksportuara; dhe
 - (ii) vlera totale e shtuar e fituar jashtë Mbretërisë së Bashkuar ose Kosovës duke zbatuar dispozitat e këtij neni nuk tejkalon 10% të çmimit të punimeve me kosto direkte të produktit përfundimtar për të cilin kërkohet statusi i origjinës.

4. Për qëllimet e paragrafit 3, kushtet për marrjen e statusit të origjinës të përcaktuara në Titullin II nuk do të zbatohen për punën ose përpunimin e bërë jashtë Mbretërisë së Bashkuar ose Kosovës. Sidoqoftë, në rastin kur në listën e Shtojcës II të Përfshirë, një rregull që përcakton një vlerë maksimale për të gjitha materialet jo-origjinuese të përfshira, zbatohet në përcaktimin e statusit të origjinës së produktit përfundimtar, vlerës totale të materialeve jo origjinuese të përfshira në territorin e Palës në fjalë, e marrë parasysh së bashku me vlerën e shtuar totale të fituar jashtë Mbretërisë së Bashkuar ose Kosovës duke zbatuar dispozitat e këtij neni, nuk do të tejkalojë përqindjen e deklaruar.

5. Për qëllime të zbatimit të dispozitave të paragrafëve 3 dhe 4, “vlera totale e shtuar” nënkupton të gjitha kostot që dalin jashtë Mbretërisë së Bashkuar ose Kosovës, përfshirë vlerën e materialeve të përfshira atje.

6. Dispozitat e paragrafëve 3 dhe 4 nuk do të zbatohen për produktet që nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në listën e Shtojcës II të Përfshirë ose të cilat mund të konsiderohen të punuara ose të përpunuara në mënyrë të mjaftueshme vetëm nëse aplikohet toleranca e përgjithshme e përcaktuar në nenin 6 (2).

7. Dispozitat e paragrafëve 3 dhe 4 nuk do të zbatohen për produktet e Kapitujve 50 deri 63 të Sistemit të Harmonizuar.

8. Çdo përpunim i llojit që mbulohet nga dispozitat e këtij neni dhe bëhet jashtë Mbretërisë së Bashkuar ose Kosovës do të bëhet në bazë të marrëveshjeve të përpunimit të jashtëm, ose marrëveshjeve të ngjashme.

NENI 13

Transporti Direkt

1. Trajtimi preferencial i parashikuar në bazë të kësaj Marrëveshjeje do të zbatohet vetëm për produktet që plotësojnë kërkesat e këtij Protokolli, të cilat transportohen direkt ndërmjet Palëve ose përmes territoreve të vendeve të tjera të përmendura në Nenet 3 dhe 4 me të cilat akumulimi është i zbatueshëm. Sidoqoftë, produktet që përbëjnë një dërgesë të vetme, nëse paraqitet nevoja mund të transportohen nëpër territore të tjera me transportim ose deponim të përkohshëm në territore të tilla, me kusht që ato të mbesin nën mbikëqyrjen e autoriteteve doganore në vendin e kalimit ose deponimit dhe të mos i nënshtrohen operacioneve të tjera përveç shkarkimit, ringarkimit ose ndonjë operacioni për t'i ruajtur ato në gjendje të mirë.

Produktet me origjinë mund të transportohen përmes tubacionit nëpër një territor tjetër i ndryshëm nga ai i Palëve.

2. Dëshmia se kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 janë përmbushur do t'u jepet autoriteteve doganore të Palës importuese me hartimin e:

- (a) një dokumenti të vetëm transporti që mbulon kalimin nga Pala eksportuese përmes vendit të kalimit; ose
- (b) një certifikate të lëshuar nga autoritetet doganore të vendit të kalimit:
 - (i) duke dhënë një përshkrim të saktë të produkteve;
 - (ii) duke deklaruar datat e shkarkimit dhe ngarkimit të produkteve dhe, kur është e përshtatshme, emrat e anijeve, ose mjetet e tjera të transportit të përdorura; dhe
 - (iii) duke vërtetuar kushtet në të cilat produktet kanë mbetur në vendin e kalimit; ose
- (c) Në mungesë të këtyre, ndonjë dokument vërtetues.

NENI 14

Ekspozitat

1. Produktet origjinale të dërguara për ekspozitë në një vend të ndryshëm nga ato të përmendura në nenet 3 dhe 4 me të cilat kumulimi është i zbatueshëm, dhe të shitura pas ekspozitës për import në Mbretërinë e Bashkuar ose Kosovë, do të përfitojnë për import nga Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, me kusht që t'i tregohet autoriteteve doganore që:

- (a) një eksportues ka dërguar këto produkte nga Mbretëria e Bashkuar ose Kosova në vendin në të cilin po mbahet ekspozita dhe i ka ekspozuar ato atje;
- (b) produktet janë shitur ose janë sistemuar nga ai eksportues tek një person në Mbretërinë e Bashkuar ose Kosovë;
- (c) produktet janë dërguar gjatë ekspozitës ose menjëherë pas kësaj në shtetin në të cilin janë dërguar për ekspozitë; dhe
- (d) produktet, pasi u dërguan për ekspozitë, nuk janë përdorur për ndonjë qëllim tjetër përveç demonstrimit në ekspozitë.

2. Një vërtetim i origjinës duhet të lëshohet ose hartohet në përputhje me dispozitat e Titullit V dhe duhet t'i dërgohet autoriteteve doganore të Mbretërisë së Bashkuar ose Kosovës në mënyrë normale. Emri dhe adresa e ekspozitës duhet të tregohen në të. Kur është e nevojshme, mund të kërkohen prova shtesë dokumentuese për kushtet në të cilat ato janë ekspozuar.

3. Paragrafi 1 do të zbatohet për çdo ekspozitë tregtare, industriale, bujqësore ose artizanale, shfaqje në panair ose shfaqje të ngjashme publike të cilat nuk janë organizuar për qëllime private në dyqane ose ambiente biznesi me qëllim shitjen e produkteve të huaja, dhe gjatë së cilës produktet mbeten nën kontrollin doganor.

TITULLI IV

KTHIMI I PAGESËS SË DOGANËS OSE LIRIMI NGA PAGESA

NENI 15

Ndalesa e Kthimit të Pagesës ose Lirimit nga Detyrimet Doganore

1. Materialet jo origjinuese të përdorura në prodhimin e produkteve me origjinë nga Mbretëria e Bashkuar ose Kosova për të cilat një është lëshuar një vërtetim i origjinës ose është bërë në përputhje me dispozitat e Titullit V, nuk do t'i nënshtrohen

kthimit ose lirimit nga pagesa e detyrimeve doganore të çfarëdo lloji, si në Mbretërinë e Bashkuar ashtu edhe në Kosovë.

2. Ndalesa në paragrafin 1 do të zbatohet për çdo marrëveshje për kthim, lirim apo mospagim, të pjesshëm ose të plotë të detyrimeve doganore ose tarifave që kanë një efekt ekuivalent, të zbatueshëm në Mbretërinë e Bashkuar ose Kosovë për materialet e përdorura në prodhim, kur një kthim i tillë, lirim apo mos-pagim zbatohet, shprehimisht ose në fuqi, kur produktet e marra nga materialet në fjalë eksportohen dhe jo kur ato mbahen për përdorim shtëpiak atje.

3. Eksportuesi i produkteve të mbuluara me vërtetim të origjinës, duhet të jetë i përgatitur të paraqesë në çdo kohë, me kërkesë të autoriteteve doganore, të gjitha dokumentet e duhura që dëshmojnë se nuk është pranuar asnjë kthim në lidhje me materialet jo origjinuese të përdorura në prodhimin e produkteve në fjalë dhe që të gjitha detyrimet doganore ose tarifave që kanë efekt ekuivalent të zbatueshëm në materialet të tilla janë paguar.

4. Dispozitat e paragrafëve 1, 2 dhe 3 të këtij neni zbatohen gjithashtu për paketim brenda kuptimit të nenit 8 (2), pajisjet shtesë, pjesët rezervë dhe mjetet brenda kuptimit të nenit 9 dhe produkteve në komplete brenda kuptimit të Nenit 10 kur sendet e tilla janë joorigjinuese.

5. Dispozitat e paragrafëve 1 deri 4 do të zbatohen vetëm për materialet që janë të llojit për të cilin kjo Marrëveshje vlen.

TITULLI V

VËRTETIMI I ORIGJINËS

NENI 16

Kërkesat e Përgjithshme

1. Produktet me origjinë nga njëra palë, pas importit tek Pala tjetër, do të përfitojnë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje pas paraqitjes së një prej vërtetimeve të mëposhtme të origjinës:

- (a) një certifikatë lëvizjeje (qarkullimi) EUR.1, një ekzemplar i së cilës paraqitet në Shtojcën III a të përfshirë;
- (b) një certifikatë lëvizjeje (qarkullimi) EUR-MED, një ekzemplar i së cilës paraqitet në Shtojcën III b të përfshirë; ose
- (c) në rastet e specifikuar në nenin 22 (1), një deklaratë (në vijim referuar si 'deklarata e origjinës' ose 'deklarata e origjinës EUR-MED') e dhënë nga eksportuesi në një faturë, një shënim dorëzimi ose ndonjë dokument

tjetër tregtar i cili përshkruan produktet në fjalë në detaje të mjaftueshme për të bërë të mundur identifikimin e tyre. Tekstet e deklaratave të origjinës paraqiten në Shtojcat e Inkorporuara IV a dhe b.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1, produktet origjinuese brenda kuptimit të këtij Protokollit, në rastet e përcaktuara në nenin 27, përfitojnë nga kjo Marrëveshje pa qenë e nevojshme të paraqitet ndonjë nga vërtetimet e origjinës të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Pavarësisht nga paragrafi 5 i nenit 17 dhe paragrafi 3 i nenit 22 më poshtë, ku kumulimi përfshin vetëm Mbretërinë e Bashkuar, Bashkimin Evropian, Zvicrën (përfshirë Lihtenshtajnin), Islandën, Norvegjinë, Ishujt Faroe, Turqi, Republikën e Shqipërisë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Republikën e Maqedonisë së Veriut, Malin e Zi, Republikën e Serbisë dhe Republikën e Kosovës, vërtetim i origjinës mund të jetë një certifikatë lëvizjeje (qarkullimi) EUR.1 ose një deklaratë origjinë.

NENI 17

Procedura për Lëshimin e një Certifikate të Qarkullimit EUR.1 ose EUR-MED

1. Një certifikatë e qarkullimit EUR.1 ose EUR-MED do të lëshohet nga autoritetet doganore të Palës eksportuese për aplikim që është bërë me shkrim nga eksportuesi ose, nën përgjegjësinë e eksportuesit, nga përfaqësuesi i tij i autorizuar.

2. Për këtë arsye, eksportuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar do ta plotësojnë si certifikatën e qarkullimit EUR.1 ose EUR-MED ashtu edhe formularin e aplikimit, mostra të të cilit gjenden në Shtojcat e Inkorporuara III a dhe b. Këta formularë do të plotësohen në një prej gjuhëve në të cilat kjo Marrëveshje është hartuar dhe në pajtim me dispozitat e ligjit shtetëror të vendit eksportues. Nëse plotësimi i formularëve bëhet me dorëshkrim, ato do të plotësohen në shtyp me shkronja të shtypit. Përshkrimi i produkteve do të jepet në rubrikën e rezervuar për këtë qëllim pa lënë ndonjë rresht të zbrazët. Në rastet kur rubrika nuk është e mbushur plotësisht, do të vizatohet një vijë horizontale nën rreshtin e fundit të përshkrimit, me hapësirën e zbrazët të kryqëzuar.

3. Eksportuesi që aplikon për lëshimin e një certifikate të qarkullimit EUR.1 ose EUR-MED do të jetë i përgatitur të paraqesë në çdo kohë, sipas kërkesës së autoriteteve doganore të Mbretërisë së Bashkuar ose të Kosovës ku lëshohet certifikata e qarkullimit EUR.1 ose EUR-MED, të gjitha dokumentet e duhura që dëshmojnë statusin origjinues të produkteve përkatëse si dhe përmbushjen e kërkesave tjera të këtij Protokollit.

4. Pa paragjykim ndaj paragrafit 5, një certifikatë e qarkullimit EUR.1 do të lëshohet nga autoritetet doganore të Mbretërisë së Bashkuar ose të Kosovës në rastet në vijim:

- (a) nëse produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë nga Mbretëria e Bashkuar ose Kosova, pa aplikim të kumulimit me materiale që e kanë origjinën në Zvicër (duke përfshirë Lihtenshtajnin), Turqinë, një prej vendeve të referuara në Nenet 3(2) dhe 4(2) dhe përmbushin kërkesat e tjera të këtij Protokolli; ose
- (b) nëse produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë nga një prej vendeve të tjera të referuara në Nenet 3 dhe 4 me të cilat aplikohet kumulimi, pa aplikim të kumulimit me materialet me origjinë nga një prej vendeve të referuara në Nenet 3 dhe 4 dhe përmbushin kërkesat tjera të këtij Protokolli, me kusht që një certifikatë EUR-MED ose një deklaram i faturës EUR-MED të jetë lëshuar në vendin e origjinës.

5. Një certifikatë e qarkullimit EUR-MED do të lëshohet nga autoritetet doganore të Mbretërisë së Bashkuar ose të Kosovës, nëse produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë nga Mbretëria e Bashkuara, Kosova, apo ndonjë prej vendeve të tjera të referuara në Nenet 3 dhe 4 me të cilat aplikohet, përmbushin kërkesat e këtij Protokolli dhe:

- (a) kumulimi është aplikuar me materiale me origjinë nga Zvicra (duke përfshirë Lihtenshtajnin), Turqinë ose një prej vendeve të tjera të referuara në Nenet 3(2) dhe 4(2); ose
- (b) produktet mund të përdoren si materiale në kontekstin e kumulimit për prodhimin e produkteve për eksportim në një prej vendeve të referuara në Nenet 3 dhe 4; ose
- (c) produktet mund të ri-eksportohen nga vendi i destinacionit në një prej vendeve të referuara në Nenet 3 dhe 4.

6. Një certifikatë e qarkullimit EUR-MED do të përmbajë një prej deklaratave të mëposhtme në gjuhën angleze në rubrikën 7:

- (a) nëse origjina është marrë nga zbatimi i kumulimit me materiale me origjinë nga një ose më shumë vende të referuara në Nenet 3 dhe 4:

‘KUMULIMI I ZBATUAR ME ... (emri i vendit/vendeve)’

- (b) nëse origjina është marrë pa zbatimin e kumulimit me materiale me origjinë nga një ose më shumë vende të referuara në Nenet 3 dhe 4:

‘NUK ËSHTË ZBATUAR KUMULIM’

7. Autoritetet doganore që lëshojnë certifikatat e qarkullimit EUR.1 ose EUR-MED do të marrin çdo hap të nevojshëm për të verifikuar statusin origjinues të produkteve dhe përmbushjen e kërkesave të tjera të këtij Protokolli. Për këtë qëllim, ata do të kenë të drejtën për të kërkuar çfarëdo dëshmie dhe të kryejnë çdo inspektim të llogarisë së eksportuesit ose ndonjë kontroll tjetër që konsiderohet i përshtatshëm.

Po ashtu, ata do të sigurohen se formularët e referuar në paragrafin 2 janë plotësuar siç duhet. Në veçanti, ata do të kontrollojnë nëse hapësira e rezervuar për përshkrimin e produkteve është plotësuar në mënyrë të tillë që të përjashtojë të gjitha mundësitë e shtesave mashtruese.

8. Data e lëshimit të certifikatës së qarkullimit EUR.1 ose EUR-MED do të tregohet në Rubrikën 11 të certifikatës.

9. Një certifikatë e qarkullimit EUR.1 ose EUR-MED do të lëshohet nga autoritetet doganore dhe do të vihet në dispozicion të eksportuesit sapo të jetë realizuar ose siguruar eksportimi.

NENI 18

Certifikatat e Qarkullimit EUR.1 ose EUR-MED të Lëshuara në mënyrë Retrospektive

1. Pavarësisht Nenit 17(9), një certifikatë e qarkullimit EUR.1 ose EUR-MED mund të lëshohet me përjashtim pas eksportimit të produkteve me të cilat ndërlidhet, nëse:

- (a) nuk është lëshuar në kohën e eksportimit për shkak të gabimeve, heqjeve të paqëllimshme ose rrethanave të veçanta; apo
- (b) u dëshmohet bindshëm autoriteteve doganore se ishte lëshuar një certifikatë e qarkullimit EUR.1 ose EUR-MED por nuk ishte pranuar në importim për arsye teknike.

2. Pavarësisht Nenit 17(9), një certifikatë e qarkullimit EUR-MED mund të lëshohet pas eksportimit të produkteve me të cilat ndërlidhet dhe për të cilat ishte lëshuar një certifikatë e qarkullimit EUR.1 në kohën e eksportimit, me kusht që iu dëshmohet bindshëm autoriteteve doganore se kushtet e referuara në Nenin 17(5) janë përmbushur.

3. Për implementimin e paragrafëve 1 dhe 2, eksportuesi do të tregojë në aplikacionin e tij vendin dhe datën e eksportimit të produkteve me të cilat ndërlidhet certifikata e qarkullimit EUR.1 ose EUR-MED dhe të tregojë arsyet për kërkesën e tij.

4. Autoritetet doganore mund ta lëshojnë një certifikatë të qarkullimit EUR.1 ose EUR-MED në mënyrë retrospektive vetëm pasi të kenë verifikuar se informatat e ofruara në aplikacionin e eksportuesit janë në përputhje me ato në dosjen përkatëse.

5. Certifikata e qarkullimit EUR.1 ose EUR-MED e lëshuar në mënyrë retrospektive me aplikim të paragrafit 1 do të nënshkruhet me frazën në vijim në gjuhën angleze:

‘ISSUED RETROSPECTIVELY (E LËSHUAR NË MËNYRË RETROSPEKTIVE)’

Certifikatat e qarkullimit EUR-MED të lëshuara në mënyrë retrospektive me aplikim të paragrafit 2 do të nënshkruhet me frazën në vijim në gjuhën angleze:

‘ISSUED RETROSPECTIVELY (E LËSHUAR NË MËNYRË RETROSPEKTIVE) (Origjinali EUR.1 Nr ... [data dhe vendi i lëshimit])’

6. Nënshkrimi i referuar në paragrafin 5 do të vendoset në Rubrikën 7 të certifikatës së qarkullimit EUR.1 ose EUR-MED.

NENI 19

Lëshimi i një Kopjeje të Certifikatës së Qarkullimit EUR.1 ose EUR-MED

1. Në rast të vjedhjes, humbjes apo shkatërrimit të një certifikate të qarkullimit EUR.1 ose EUR-MED, eksportuesi mund të aplikojë tek autoritetet doganore të cilat e kanë lëshuar atë për një kopje të bërë në bazë të dokumenteve të eksportit që i posedojnë.

2. Kopja e lëshuar në këtë mënyrë do të nënshkruhet me fjalën në vijim në gjuhën angleze:

‘KOPJE’

3. Nënshkrimi i referuar në paragrafin 2 do të vendoset në Rubrikën 7 të certifikatës kopje të lëvizjes EUR.1 ose EUR-MED.

4. Kopja, e cila do ta mbajë datën e lëshimit të certifikatës origjinale të qarkullimit EUR.1 ose EUR-MED, do të hyjë në fuqi nga ajo datë.

NENI 20

Lëshimi i Certifikatave të Lëvizjes EUR.1 ose EUR-MED në bazë të një Dëshmie të Origjinës të Lëshuar ose të Hartuar më Herët

Kur produktet origjinuese vendosen nën kontrollin e zyrës doganore në Mbretërinë e Bashkuar ose në Kosovë, do të jetë e mundur të zëvendësohet dëshmia origjinale e origjinës përmes një apo më shumë certifikatave të qarkullimi EUR.1 ose EUR-MED me qëllim të dërgimit të të gjitha ose disa prej këtyre produkteve diku tjetër brenda Mbretërisë së Bashkuar apo Kosovës. Certifikata(t) zëvendësuese e qarkullimit EUR.1 ose EUR-MED do të lëshohet nga zyra doganore nën kontrollin e së cilës janë vendosur produktet.

NENI 21

Llogaritja e Ndarjes

1. Kur paraqiten shpenzime të konsiderueshme apo vështirësi materiale në mbajtjen e stoqeve të ndara të produkteve origjinuese dhe jo-origjinuese që janë identike dhe të këmbyeshme, autoritetet doganore, pas kërkesës me shkrim të personave përkatës, mund ta autorizojnë metodën e ashtuquajtur “llogaritja e ndarjes” (këtu e tutje referuar si ‘metoda’) për tu përdorur për menaxhimin e rezervave të tilla.
2. Metoda do të sigurojë se, për një periudhë të caktuar të referimit, numri i produkteve të pranura që do të mund të konsideroheshin si ‘origjinuese’ është i njëjtë si ai që do të pranohej po të kishte pasur ndarje fizike të stoqeve.
3. Autoritetet doganore mund ta kushtëzojnë të drejtën për autorizim, të referuar në paragrafin 1, me çfarëdo kushtesh që konsiderohen të përshtatshme.
4. Metoda do të aplikohet dhe aplikimi i saj do të regjistrohet në bazë të parimeve të përgjithshme të llogaritjes që janë në fuqi në shtetin ku është prodhuar produkti.
5. Përfituesi i metodës mund të hartojë apo aplikojë për dëshmi të origjinës, varësisht nga rasti, për sasinë e produkteve që mund të konsiderohen si produkte origjinuese. Me kërkesë të autoriteteve doganore, përfituesi do të japë një deklaratë të mënyrës si janë menaxhuar sasinë.
6. Autoritetet doganore do ta monitorojnë përdorimin e autorizimit dhe mund ta tërheqin atë kurdo që përfituesi e përdor atë në mënyrë jo të duhur në çfarëdo mënyre apo dështon t’i plotësojë ndonjë prej kushteve të tjera të paraqitura në këtë Protokoll.

NENI 22

Kushtet për Hartimin e një Deklarate të Origjinës apo një Deklaratë të Origjinës EUR-MED

1. Një deklaratë e origjinës apo një deklaratë e origjinës EUR-MED siç është referuar në Nenin 16 (1) (c) mund të hartohet:
 - (a) nga një eksportues i aprovuar brenda kuptimit të Nenit 23; ose
 - (b) nga çdo eksportues për çfarëdo dërgese të përbërë nga një apo më shumë pako që përmbajnë produkte origjinuese vlera e përgjithshme e të cilave nuk e kalon shumën EUR 6000.
2. Pa paragjykim ndaj paragrafit 3, një deklaratë e origjinës mund të hartohet në rastet në vijim:

- (a) nëse produktet në fjalë mund të konsiderohen si produkte me origjinë në Mbretërinë e Bashkuar apo në Kosovë, pa aplikim të kumulimit me materialet me origjinë në Zvicër (duke përfshirë Lihtenshtajnin), Turqi apo në një prej vendeve të tjera të referuara në Nenet 3(2) dhe 4(2) dhe përmbushin kërkesat e tjera të këtij Protokolli; apo
- (b) nëse produktet në fjalë mund të konsiderohen si produkte origjinuese në një prej vendeve të tjera të referuara në Nenet 3 dhe 4 me të është i zbatueshëm kumulimi, pa zbatim të kumulimit me materiale që kanë origjinën në një prej vendeve të referuara në Nenet 3 dhe 4 dhe përmbushin kërkesat e tjera të këtij Protokolli, me kusht që një certifikatë EUR-MED apo një deklaratë e faturës EUR-MED është lëshuar në vendin e origjinës

3. Një deklaratë e origjinës EUR-MED mund të hartohet nëse një prej produkteve në fjalë mund të konsiderohet si produkte me origjinë nga Mbretëria e Bashkuar, Kosova apo një prej vendeve të tjera të referuara në Nenet 3 dhe 4 me të cilat është i zbatueshëm kumulimi dhe përmbushin kërkesat e këtij Protokolli, në rastet në vijim:

- (a) kumulimi është zbatuar me materiale me origjinë nga Zvicra (duke përfshirë Lihtenshtajnin), Turqinë apo një prej vendeve të tjera të referuara në Nenet 3(2) dhe 4(2); ose
- (b) produktet mund të përdoren si materiale në kontekstin e kumulimit për prodhimin e produkteve për eksportim në një prej vendeve të referuara në Nenet 3 dhe 4; apo (c) produktet mund të rieksporthen nga vendi i destinacionit në një prej vendeve të tjera të referuara në Nenet 3 dhe 4.

4. Një deklaratë e origjinës EUR-MED do të përmbajë një prej deklaratave të mëposhtme në gjuhën angleze:

- (a) nëse origjina është marrë nga zbatimi i kumulimit me materiale me origjinë nga një ose më shumë vende të referuara në Nenet 3 dhe 4:

‘KUMULIMI I ZBATUAR ME ... (emri i vendit/vendeve)’

- (b) nëse origjina është marrë pa zbatimin e kumulimit me materiale me origjinë nga një ose më shumë vende të referuara në Nenet 3 dhe 4:
‘NUK ËSHTË ZBATUAR KUMULIM’

5. Eksportuesi që bën një deklaratë të origjinës apo një deklaratë të origjinës EUR-MED do të jetë i përgatitur për të paraqitur në çdo kohë, me kërkesë të autoriteteve doganore të Palës eksportuese, të gjitha dokumentet e duhura që dëshmojnë statusin e origjinës së produkteve përkatëse si dhe përmbushjen e kërkesave të tjera të këtij Protokolli.

6. Një deklaratë e origjinës apo një deklaratë e origjinës EUR-MED do të hartohet nga eksportuesi duke shtypur, vulosur apo printuar faturën, fletëngarkesën apo ndonjë dokument tjetër tregtar, deklaratën, tekstet e të cilave paraqiten në Shtojcat e

Inkorporuara IV a dhe b, duke përdorur një nga versionet gjuhësore të përcaktuara në ato Shtojca dhe në pajtim me dispozitat e ligjit shtetëror të vendit eksportues. Nëse deklarata është e shkruar me dorëshkrim, ajo do të shkruhet në shtyp me shkronja shtypi.

7. Deklaratat e origjinës dhe deklaratat e origjinës EUR-MED do ta mbajnë nënshkrimin origjinal të eksportuesit në dorëshkrim. Megjithatë, një eksportuesi të aprovuar brenda kuptimit të Nenit 23 nuk do t'i kërkohet të nënshkruajë deklarata të tilla nëse ai u jep autoriteteve doganore të Palës eksportuese një zotim të shkruar se ai pranon përgjegjësi të plotë për çdo deklaratë të origjinës që e identifikon atë sikur të ishte nënshkruar në dorëshkrim nga ai.

8. Një deklaratë e origjinës apo një deklaratë e origjinës EUR-MED mund të bëhet nga eksportuesi kur produktet me të cilat ndërlidhet ajo janë eksportuar, apo pas eksportimit me kusht që të prezantohet në vendin importues të paktën dy vite pas importimit të produkteve me të cilat ndërlidhet.

NENI 23

Eksportues i Aprovuar

1. Autoritetet doganore të Palës eksportuese mund ta autorizojnë çdo eksportues (këtu e tutje i referuar si 'eksportuesi i aprovuar'), me ngarkesa të shpeshta të produkteve në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje për të hartuar deklarata të origjinës apo deklarata të origjinës EUR-MED pavarësisht vlerës së produkteve në fjalë. Eksportuesi që kërkon autorizim të tillë do t'u ofrojë autoriteteve doganore të gjitha garancitë e nevojshme për të verifikuar statusin e origjinës së produkteve si dhe përmbushjen e kërkesave të tjera të këtij Protokolli.
2. Autoritetet doganore mund ta kushtëzojnë lejen për status të eksportuesit të aprovuar me çfarëdo kushtesh që ata i konsiderojnë të përshtatshme.
3. Autoritetet doganore do t'ia japin eksportuesit të aprovuar një numër të autorizimit doganor i cili do të paraqitet në deklaratën e origjinës apo në deklaratën e origjinës EUR-MED.
4. Autoritetet doganore do ta monitorojnë përdorimin e autorizimit nga eksportuesi i aprovuar.
5. Autoritetet doganore mund ta tërheqin autorizimin në çdo kohë. Ata do ta bëjnë këtë kur eksportuesi i aprovuar nuk ofron më garancitë e referuara në paragrafin 1, nuk i përmbush më kushtet e referuara në paragrafin 2 apo e përdor autorizimin në ndonjë mënyrë tjetër që është e gabuar.

NENI 24

Vlefshmëria e Dëshmisë së Origjinës

1. Një dëshmi e origjinës do të jetë e vlefshme katër muaj nga data e lëshimit në Palën eksportuese dhe do t'u dorëzohet brenda asaj periudhe autoriteteve doganore të Palës importuese.
2. Dëshmitë e origjinës që iu dorëzohen autoriteteve doganore të Palës importuese pas datës finale për paraqitje të përcaktuar në paragrafin 1 mund të pranohen me qëllim të zbatimit të trajtimit preferencial, në rastet kur dështimi për t'i dorëzuar këto dokumente para datës përfundimtare është për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme.
3. Në raste të tjera të paraqitjes së vonuar, autoritetet doganore të Palës importuese mund të pranojnë dëshmi të origjinës kur produktet janë dorëzuar para datës përfundimtare në fjalë.

NENI 25

Dorëzimi i Dëshmisë së Origjinës

Dëshmitë e origjinës do t'u dorëzohen autoriteteve doganore të Palës importuese në pajtim me procedurat në fuqi në atë shtet. Autoritetet në fjalë mund të kërkojnë përkthim të dëshmisë së origjinës dhe po ashtu mund të kërkojnë që deklarata e importimit të shoqërohet me një deklaratë nga importuesi me kuptimin se produktet i përmbushin kushtet e nevojshme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

NENI 26

Importimi Përmes Situacioneve

Në rastet kur, me kërkesë të importuesit dhe nën kushtet e caktuara nga autoritetet doganore të Palës importuese, produktet e zbërthyera apo të çmontuara brenda kuptimit të Rregullës së Përgjithshme 2(a) të Sistemit të Harmonizuar që është pjesë e Pjesëve XVI dhe XVII apo të kapitujve 7308 dhe 9406 të Sistemit të Harmonizuar importohen përmes situacioneve, autoriteteve doganore do t'iu dorëzohet vetëm një dëshmi e origjinës për produktet e tilla pas importimit të situacionit të parë.

NENI 27

Lirimi nga Dëshmia e Origjinës

1. Produktet e dërguara si pako të vogla nga persona privatë tek persona privatë apo që janë pjesë e bagazhit personal të Udhëtarëve do të pranohen si produkte origjinuese pa kërkuar dorëzim të dëshmisë së origjinës, nëse produktet e tilla nuk importohen përmes tregtisë dhe janë deklaruar si produkte që i përmbushin kërkesat e këtij Protokollit dhe kur nuk ka dyshim për vërtetësinë e një deklarate të tillë. Në rast të produkteve të dërguara përmes postës, ajo deklaratë mund të bëhet mbi deklaratën doganore CN22 / CN23 apo në një fletë të bashkangjitur si shtojcë e atij dokumenti.

2. Importimet që janë të rralla dhe që përbëhen vetëm nga produkte për përdorim personal të marrësve apo të udhëtarëve ose familjeve të tyre nuk do të konsiderohen importime përmes tregtisë nëse është e qartë nga natyra dhe sasia e produkteve se nuk duket qëllimi komercial.

3. Po ashtu, vlera e përgjithshme e këtyre produkteve nuk do të tejkalojë shumën EUR 500 në rast të pakove të vogla apo EUR 1,200 në rast të produkteve që janë pjesë e bagazhit personal të udhëtarëve.

NENI 28

Dokumentet Mbështetëse

Dokumentet e referuara në Nenet 17(3) dhe 22(5) të përdorura me qëllim të dëshmimit se produktet e mbuluara nga një certifikatë e qarkullimit EUR.1 ose EUR-MED, apo një deklaratë e origjinës ose deklaratë e origjinës EUR-MED mund të konsiderohen si produkte me origjinë në Mbretërinë e Bashkuar, në Kosovë apo në një prej vendeve të tjera të referuara në Nenet 3 dhe 4 dhe përmbushin kërkesat e tjera të këtij Protokollit mund të përbëhen, *mes tjerash*, nga këto:

- (a) dëshmi direkte të procesit të realizuar nga eksportuesi apo furnizuesi për t'i marrë mallrat përkatëse, të përmbajtura për shembull në llogaritë e tij apo në llogaritë e brendshme;
- (b) dokumente që dëshmojnë statusin e origjinës së materialeve të përdorura, të lëshuara ose të hartuara në Mbretërinë e Bashkuar apo në Kosovë ku këto dokumente përdoren në pajtim me ligjin shtetëror;
- (c) dokumente që dëshmojnë punimin apo përpunimin e materialeve në Mbretërinë e Bashkuar apo në Kosovë, të lëshuara apo të hartuara në Mbretërinë e Bashkuar apo në Kosovë, ku këto dokumente përdoren në pajtim me ligjin shtetëror;
- (d) certifikatat e qarkullimit EUR.1 ose EUR-MED apo deklarata të origjinës ose deklarata të origjinës EUR-MED që dëshmojnë statusin e origjinës së materialeve të përdorura, të lëshuara ose të hartuara në Mbretërinë e Bashkuar apo në Kosovë në pajtim me këtë Protokoll, apo në një prej vendeve të tjera të referuara në Nenet 3 dhe 4, në pajtim me rregullat e origjinës që janë të njëjta me rregullat e këtij Protokolli;
- (e) dëshmi të përshtatshme lidhur me punimin apo përpunimin e realizuar jashtë Mbretërisë së Bashkuar, Kosovës apo vendeve të tjera të referuara në Nenet 3 dhe 4 duke zbatuar Nenin 12, që dëshmon se janë përmbushur kërkesat e atij Neni.

NENI 29

Ruajtja e Dëshmisë së Origjinës dhe Dokumenteve Mbështetëse

1. Eksportuesi që aplikon për lëshimin e certifikatës së qarkullimit EUR.1 ose EUR-MED do t'i mbajë për së paku tri vite dokumentet e referuara në Nenin 17(3).
2. Eksportuesi që bën një deklaratë të origjinës apo deklaratës së origjinës EUR-MED do të mbajë për së paku tri vite një kopje të kësaj deklarate të origjinës si dhe të dokumenteve të referuara në Nenin 22(5).
3. Autoritetet doganore të Palës eksportuese që lëshojnë një certifikatë të qarkullimit EUR.1 ose EUR-MED do ta mbajnë për së paku tri vite formularin e aplikimit të referuar në Nenin 17(2).
4. Autoritetet doganore të Palës importuese do t'i mbajë për së paku tri vite certifikatat e qarkullimit EUR.1 dhe EUR-MED dhe deklaratat e origjinës dhe deklaratat e origjinës EUR-MED që iu janë dorëzuar.

NENI 30

Mospërputhjet dhe Gabimet Formale

1. Zbulimi i mospërputhjeve të vogla mes deklaratave të bëra në dëshminë e origjinës dhe mes atyre të bëra në dokumentet që iu janë dorëzuar zyrës doganore me qëllim të kryerjes së formaliteteve për importimin e produkteve nuk *sipas fakteve* do ta bëjnë dëshminë e origjinës të pavlefshme apo boshe nëse është përcaktuar siç duhet se ky dokument korrespondon me produktet e dorëzuara.
2. Gabimet e dukshme formale, si gabimet e shtypit, në dëshminë e origjinës nuk do të bëjnë që ky dokument të refuzohet nëse këto gabime nuk janë të tilla që krijojnë dyshime lidhur me saktësinë e deklaratave të bëra në këtë dokument.

NENI 31

Shumat e Shprehura në Euro

1. Për zbatimin e dispozitave të Nenit 22 (1) (b) dhe Nenit 27 (3) në rastet kur produktet janë faturuar në valutë tjetër pos euros, shumat në valutat shtetërore të shteteve të referuara në Nenet 3 dhe 4 të barasvlershme me shumat e shprehura në euro do të përcaktohen në baza vjetore nga secili shtet përkatës.
2. Një dërgesë do të përfitojë nga dispozitat e Nenit 22 (1) (b) ose Nenit 27 (3) duke iu referuar valutës në të cilën është hartuar fatura, sipas shumës së caktuar nga Pala përkatëse.
3. Shumat që do të përdoren në çfarëdo valute shtetërore do të jenë të barasvlershme në atë valutë të shumave të shprehura në euro si në ditën e parë të punës të muajit tetor dhe do të vlejë nga 1 janari i vitit të ardhshëm. Palët do ta njoftojnë njëra-tjetrën për shumat përkatëse.
4. Një palë mund ta rumbullakojë shumën duke e ulur apo duke e zbritur, si rrjedhojë e konversionit në valutën e saj shtetërore të një shume të shprehur në euro. Shuma e rumbullakuar nuk mund të dallojë nga shuma si rrjedhojë e konversionit për më shumë se 5%. Një vend mund ta mbajë të pandryshuar barasvlerën e valutës së tij shtetërore të një shume të shprehur në euro nëse, në kohën e ndryshimit vjetor të paraparë në paragrafin 3, konversioni i asaj shume, para ndonjë rumbullakimi, rezulton në rritje prej më pak se 15% në barasvlerën e valutës shtetërore. Barasvlera e valutës shtetërore mund të mbahet e pandryshuar nëse konversioni do të rezultonte në ulje në atë vlerë ekuivalente.
5. Shumat e shprehura në euro do të shqyrtohen nga Këshilli për Partneritet, Tregti dhe Bashkëpunim me kërkesë të cilësdo Palë. Gjatë realizimit të këtij shqyrtimi, Këshilli për Partneritet, Tregti dhe Bashkëpunim do ta marrë parasysh pëlqimin për t'i ruajtur efektet e limiteve përkatëse në afate reale. Për këtë arsye, ai mund të vendosë t'i modifikojë shumat e shprehura në euro.

TITULLI VI

MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM ADMINISTRATIV

NENI 32

Ndihma e Përbashkët

1. Autoritetet doganore të Mbretërisë së Bashkuar dhe të Kosovës do t'i ofrojnë njëra-tjetrës vula mostra të vulave të përdorura në zyrat e tyre doganore për lëshimin e certifikatave të lëvizjes EUR.1 dhe EUR-MED dhe me adresat e autoriteteve doganore përgjegjëse për verifikimin e atyre certifikatave, deklaratave të origjinës dhe deklaratave të origjinës EUR-MED.
2. Për të siguruar zbatimin e duhur të këtij Protokollit, Mbretëria e Bashkuar dhe Kosova do t'i ndihmojnë njëra-tjetrës, përmes administratave kompetente doganore, në kontrollimin e vërtetësisë së certifikatave të qarkullimit EUR.1 dhe EUR-MED, deklaratave të origjinës dhe deklaratave të origjinës EUR-MED dhe saktësisë së informatave të dhëna në këto dokumente.

NENI 33

Verifikimi i Dëshmime të Origjinës

1. Verifikimet pasuese të dëshmime të origjinës do të realizohen rastësisht apo kurdo që autoritetet doganore të Palës importuese kanë dyshime të arsyeshme lidhur me vërtetësinë e dokumenteve të tilla, të statusit të origjinës së produkteve përkatëse apo të përmbushjes së kërkesave të tjera të këtij Protokollit.
2. Me qëllim të zbatimit të dispozitave të paragrafit 1, autoritetet doganore të Palës importuese do t'ua kthejnë certifikatën e lëvizjes EUR.1 ose EUR-MED dhe faturën, nëse është dorëzuar, deklaratën e origjinës apo deklaratën e origjinës EUR-MED, ose një kopje të këtyre dokumenteve autoriteteve doganore të Palës eksportuese, duke dhënë, në rastet kur kjo është e duhur, arsye për kërkesën për verifikim. Të gjitha dokumentet dhe informatat e marra që sugjerojnë se informatat e dhëna mbi dëshminë e origjinës janë të pasakta do të dërgohet në mbështetje të kërkesës për verifikim.
3. Verifikimi do të kryhet nga autoritetet doganore të Palës eksportuese. Për këtë arsye, ata do të kenë të drejtë të kërkojnë çfarëdo dëshmie dhe të kryejnë çfarëdo inspektimi të llogarive të eksportuesit apo ndonjë kontroll tjetër që konsiderohet i përshtatshëm.
4. Nëse autoritetet doganore të Palës importuese vendosin ta suspendojnë lejen e trajtimit preferencial për produktet përkatëse përderisa presin rezultatet e verifikimit,

importuesit do t'i ofrohet lirimi i produkteve i kushtëzuar me çfarëdo masash parandaluese që vlerësohen të nevojshme.

5. Autoritetet doganore që kërkojnë verifikim do të informohen për rezultatet e këtij verifikimi sa më shpejt që të jetë e mundur. Këto rezultate do të tregojnë qartë nëse dokumentet janë autentike dhe nëse produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë në Mbretërinë e Bashkuar, në Kosovë apo në një prej shteteve të tjera të referuara në Nenet 3 dhe 4 dhe i përmbushin kërkesat e tjera të këtij Protokollit.

6. Nëse, në raste të dyshimeve të arsyeshme, nuk ka përgjigje brenda dhjetë muajve të datës së kërkesës për verifikim apo nëse përgjigja nuk përmban informata të mjaftueshme për të përcaktuar vërtetësinë e dokumentit në fjalë apo origjinën e vërtetë të produkteve, autoritetet doganore që e kanë bërë kërkesën, përveç në rrethana të jashtëzakonshme, do ta refuzojnë të drejtën për preferencat.

NENI 34

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Kur paraqiten mosmarrëveshje lidhur me procedurat e verifikimit të Nenit 33 të cilat nuk mund të zgjidhen mes autoriteteve doganore që kërkojnë verifikim dhe autoriteteve doganore përgjegjëse për kryerjen e këtij verifikimi, ato do t'i dorëzohen Këshillit për Partneritet, Tregti dhe Bashkëpunim.

Në të gjitha rastet, zgjidhja e mosmarrëveshjeve mes importuesit dhe autoriteteve doganore të Palës importuese do të bëhet sipas legjislacionit të asaj Pale.

NENI 35

Dënimet

Dënimet do të shqiptohen për çdo person që harton apo shkakton hartimin e një dokumenti i cili përmban informata të pasakta me qëllim të fitimit të trajtimit preferencial për produkte.

NENI 36

Zonat e Lira

1. Mbretëria e Bashkuar dhe Kosova do t'i marrin të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar se produktet e këmbëyerë nën një dëshmi të origjinës të cilat gjatë rrjedhës së transportit përdorin një zonë të lirë të ndodhur në territorin e tyre, nuk zëvendësohen me mallra të tjera dhe nuk trajtohen përpos me operacionet normale të caktuara për të parandaluar dëmtimin e tyre.

2. Përmes derogimit nga paragrafi 1, kur produktet me origjinë nga Mbretëria e Bashkuar apo Kosova importohen në një zonë të lirë nën dëshminë e origjinës dhe kalojnë nëpër trajtim ose përpunim, autoritetet përkatëse do ta lëshojnë një certifikatë të re të qarkullimit EUR.1 ose EUR-MED me kërkesë të eksportuesit, nëse trajtimi apo përpunimi i kryer përputhet me këtë Protokoll.

NENI 37

Derogimi

Produktet e radhitura më poshtë do të përjashtohen nga kumulimi i parashikuar në nenet 3 dhe 4, përveç kumulimit në lidhje me Bashkimin Evropian (të parashikuar në paragrafët 1 dhe 3 të nenit 3), nëse:

- (a) shteti i destinacionit përfundimtar është Mbretëria e Bashkuar dhe:
 - (i) materialet e përdorura në prodhimin e këtyre produkteve janë me origjinë nga Republika e Shqipërisë, Bosnja dhe Hercegovina, Republika e Maqedonisë Veriore, Mali i Zi, Republika e Serbisë dhe Republika e Kosovës; ose
 - (ii) këto produkte e kanë marrë origjinën e tyre në bazë të punimit apo përpunimit të kryer në cilindo prej shteteve të referuara në paragrafin (a) (i); ose
- (b) shteti i destinacionit përfundimtar është Kosova dhe:
 - (i) materialet e përdorura në prodhimin e këtyre produkteve janë me origjinë nga Mbretëria e Bashkuar; ose
 - (ii) këto produkte e kanë marrë origjinën e tyre në bazë të punimit apo përpunimit të kryer në Mbretërinë e Bashkuar.

Kodi CN	Përshkrimi
1704 90 99	Ëmbëlsirat e tjera me sheqer, që nuk përmbajnë kakao
1806 10 30	Çokollata dhe përgatesat e tjera ushqimore që përmbajnë kakao
1806 10 90	– Pluhuri i kakaos, që përmban sheqer të shtuar apo materie ëmbëlsuese: – – që përmbajnë 65% apo më shumë por më pak se 80% nga pesha e saharozës (duke përfshirë sheqerin invert të shprehur si saharozë) apo izoglukoza e shprehur si saharozë

	-- Që përmbajnë 80% apo më shumë nga pesha e saharozës (duke përfshirë sheqerin të shprehur) apo izoglukoza e shprehur si saharozë
1806 20 95	– Përgatesat e tjera ushqimore që përmbajnë kakao në kuti, pllaka apo shirita më shumë se 2 kg apo në formë të lëngshme, paste, pluhuri apo forma të tjera të mëdha në kontejnerë apo paketim të menjëhershëm të një përmbajtjeje që kalon masën 2 kg -- Të tjera --- Të tjera
1901 90 99	Ekstrakti i maltit, përgatesat ushqimore të miellit, bollgurit, miellit të misrit, që nuk përmbajnë kakao apo që përmbajnë më pak se 40% nga pesha e kakaos e llogaritur në baza plotësisht pa yndyrë, të paspecifikuara apo të përfshira diku tjetër, përgatesat ushqimore të mallrave në kapitujt 0401 to 0404, që nuk përmbajnë kakao apo që përmbajnë më pak se 5% nga pesha e kakaos e llogaritur në baza plotësisht pa yndyrë, të paspecifikuara apo të përfshira të diku tjetër – Të tjera -- Të tjera (përpos ekstraktit të maltit) --- Të tjera
2101 12 98	Përgatesa të tjera me bazë të kafesë
2101 20 98	Përgatesa të tjera me bazë të çajit apo matesë
2106 90 59	Përgatesat ushqimore që nuk janë specifikuar apo përfshirë diku tjetër – Të tjera -- Të tjera
2106 90 98	Përgatesat ushqimore që nuk janë specifikuar apo përfshirë diku tjetër: – Të tjera (përpos koncentrateve të proteinës dhe substancave të proteinës me teksturë) -- Të tjera --- Të tjera
3302 10 29	Përzierjet e substancave dhe përzierjeve aromatike (duke përfshirë tretësirat alkoolike) me bazë të një apo më shumë prej këtyre substancave, të një lloji të përdorur si lëndë e parë në industri; përgatesat e tjera me bazë në substanca aromatike, të një lloji të përdorur për prodhimin e pijeve: – Të një lloji të përdorur në industrinë ushqimore apo të pijeve -- Të llojit të përdorur në industrinë e pijeve: --- Përgatesat që përmbajnë të gjithë agjentët e shijeve që e karakterizojnë një pije: ---- Të një fuqie të caktuar alkoolike me volum që tejkalon 0,5%

----- Të tjera:

----- Që nuk përmbajnë yndyra të qumështit, saharozë, izoglukoze apo niseshte, apo që përmbajnë, përmes peshës, më pak se 1,5% yndyrë të qumështit, 5% saharozë ose izoglukoze, 5% glukozë apo niseshte

-----Të tjera

KAPITULLI VII

CEUTA DHE MELILLA

NENI 38

Zbatimi i Protokollit

Termi ‘Bashkim Evropian’ i përdorur në këtë Protokoll nuk e mbulon Ceutën dhe Melillën. Produktet me origjinë nga Ceuta dhe Melilla nuk konsiderohen produkte me origjinë nga Bashkimi Evropian për qëllime të këtij Protokollit.

KAPITULLI VIII

DISPOZITAT E FUNDIT

NENI 39

Dispozitat Tranzicionale për Mallra në Tranzit ose Deponim

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje mund të zbatohen për mallrat që janë në përputhje me dispozitat e këtij Protokollit dhe të cilat, në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, janë qoftë në tranzit ose janë në Mbretërinë e Bashkuar apo në Kosovë në deponim të përkohshëm në depo doganore apo në zona të lira, subjekt i dorëzimit tek autoritetet doganore të shtetit importues, brenda dymbëdhjetë muajve të datës në fjalë, të një certifikate të qarkullimit EUR.1 ose EUR-MED të lëshuar në mënyrë retrospektive nga autoritetet doganore të shtetit eksportues së bashku me dokumentet që tregojnë se mallrat janë transportuar drejtpërdrejt në përputhje me dispozitat e Nenit 13.

NENI 40

Shtojcat

1. Shtojcat I deri IV b të Shtojcës I të Konventës Rajonale mbi rregullat pan-euro-mediterrane preferenciale të origjinës janë inkomporuar dhe bërë pjesë e këtij Protokollit si Shtojca të Inkomporuara I deri IV b të këtij Protokollit dhe do të zbatohen, *mutatis mutandis*, subjekt të modifikimeve në vijim:

(a) Në Shtojcën I:

- (i) të gjitha referencat ndaj “Nenit 5 të kësaj Shtojce” do të kuptohen si referenca ndaj “Nenit 6 të këtij Protokollit”; dhe

- (ii) në paragrafin 3.1 të Shënimit 3, “një Palë Kontraktuese” do të zëvendësohet me “cilëndo prej vendeve të tjera të referuara në Nenet 3 dhe 4 ku zbatohet kumulimi”.
 - (b) Në secilën prej Shtojcave III a dhe III b, referencat ndaj “Palëve Kontraktuese” do të kuptohen si referenca ndaj “Palëve”.
 - (c) Në secilën prej Shtojcave IV a dhe IV b:
 - (i) do të inkorporohen vetëm versionet shqip, anglisht dhe serbisht të deklaratës së origjinës; dhe
 - (ii) fjalia e dytë e fusnotës 2 nuk do të përfshihet.
2. Shtojcat e këtij Protokolli do të përbëjnë një pjesë kyçe të tij.

NENI 41

Ndryshime të Këtij Protokolli

Këshilli për Partneritet, Tregti dhe Bashkëpunim mund të vendosë t’i ndryshojë dispozitat e këtij Protokolli në përputhje me nenin 11 (2) të këtij dokumenti ligjor.

Aneksi A

Lista e Referuar në Nenet 3 (2) dhe 4 (2) të Protokollit III

1. Republika Demokratike e Popullit e Algjerisë
2. Republika Arabe e Egjiptit
3. Shteti i Izraelit
4. Mbretëria Hashemite e Jordanit
5. Republika e Libanit
6. Mbretëria e Marokut
7. Organizata e çlirimit të Palestinës për të mirën e Autoritetit Palestinez të Bregut Perëndimor dhe Rripit të Gazës
8. Republika Arabe Siriane
9. Republika e Tunizisë
10. Republika e Shqipërisë
11. Bosnja dhe Hercegovina
12. Republika e Maqedonisë së Veriut
13. Mali i Zi
14. Republika e Serbisë
15. Mbretëria e Danimarkës në lidhje me Ishujt Faroe
16. Republika e Moldavisë
17. Gjeorgjia
18. Ukraina

Aneksi B

Deklaratë e Përbashkët në Lidhje me Principatën e Andorrës

1. Produktet me origjinë nga Principata e Andorrës që plotësojnë kushtet e neneve 3 (7) (b) (ii) dhe 4 (5) (b) (ii) të Protokollit III, dhe që hyjnë në Kapitujt 25 deri 97 të Sistemit të Harmonizuar do të pranohen nga Palët si me origjinë në Bashkimin Evropian në kuptimin e kësaj Marrëveshjeje.
2. Protokoli III do të zbatohet *mutatis mutandis* me qëllim të përcaktimit të statusit të origjinës së produkteve të lartpërmendura.

Aneksi C

Deklaratë e Përbashkët në Lidhje me Republikën e San Marinos

1. Produktet me origjinë nga Republika e San Marinos, që plotësojnë kushtet e neneve 3 (7) (b) (ii) dhe 4 (5) (b) (ii) të Protokollit III, do të pranohen nga Palët si me origjinë në Bashkimin Evropian brenda kuptimit të Marrëveshjes.
2. Protokollit III do të zbatohet *mutatis mutandis* me qëllim të përcaktimit të statusit të origjinës së produkteve të lartpërmendura.

ANEKSI III

Pas ANEKSIT II të Marrëveshjes së Inkorporuar, më poshtë do të futet si Aneks i ri:

ANEKSI IIA

MARRËVESHJET PREFERENCIALE SHITESË PËR PRODUKTE TË CAKTUARA BUJQËSORE DHE VERËRA

Ky Aneks përcakton marrëveshje preferenciale shitesë të ofruara përkohësisht nga Mbretëria e Bashkuar për Republikën e Kosovës për disa produkte bujqësore dhe verëra.

NENI 1

Marrëveshjet Preferenciale për disa Produkte Bujqësore me Origjinë nga Republika e Kosovës

Pavarësisht nga neni 28 (2) i Marrëveshjes së Inkorporuar, për kohën që ky Aneks është në fuqi produktet me origjinë nga Republika e Kosovës të mbuluara nga Kapitujt 7 dhe 8 të Nomenklaturës së Kombinuar pranohen për import në Mbretërinë e Bashkuar me përjashtim nga specifikat detyrimet doganore dhe tarifatat që kanë efekt ekuivalent.

NENI 2

Marrëveshjet Preferenciale për disa Produkte të verës me Origjinë nga Republika e Kosovës

1. Për verën, siç përmendet në Shtojcën e këtij Aneksi, me origjinë nga Republika e Kosovës, detyrimet doganore të zbatueshme për importet në Mbretërinë e Bashkuar, nën paragrafin 2, pezullohen në nivele, brenda kufijve të kuotave tarifore të Mbretërisë së Bashkuar dhe në kushtet e treguara për verën në Shtojcën e këtij Aneksi.
2. Qasja për verën me origjinë nga Republika e Kosovës në kuotën tarifore të paraqitur në Shtojcën e këtij Aneksi i nënshtrohet kuotave tarifore paraprake të parashikuara në Aneksin I të Protokollit II të Marrëveshjes së Inkorporuar (siç është ndryshuar në nenin 8 deri në këtë dokument ligjor).
3. Neni 8 (2) i këtij dokumenti ligjor do të zbatohet për këtë Shtojcë.

NENI 3

Kohëzgjatja e Marrëveshjeve Preferenciale

1. Marrëveshjet preferenciale të përcaktuara në nenin 1 dhe 2 të këtij aneksi skadojnë 5 vjet pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.
2. Pas skadimit të këtij aneksi, marrëveshjet preferenciale për ato produkte të përmendura në nenet 1 dhe 2 do të përcaktohen diku tjetër në këtë Marrëveshje.
3. Pavarësisht nga paragrafi 1, Mbretëria e Bashkuar mundet që përmes një njoftimi paraprak 6 mujor me shkrim ndaj Republikës së Kosovës, ose një periudhë tjetër njoftimi siç mund të bihet dakord nga palët, të zgjasë kohëzgjatjen e këtij aneksi për atë periudhë siç e gjykon të përshtatshme.

NENI 4

Marrëdhënia me Marrëveshjen e Inkorporuar

Nenet 136 (3), 137 dhe Protokollu V i Marrëveshjes së Inkorporuar nuk zbatohen për këtë Aneks.

Shtojca A

Tabela e Marrëveshjeve Preferenciale për Verën

Porosia Nr.	Kodi CN ³	Përshkrimi	Vëllimi i Kuotës në vit	Shkalla e lirit nga detyrimet
09.1530	ex 2204 21 93 ex 2204 21 94 ex 2204 21 95 ex 2204 21 96 ex 2204 21 97 ex 2204 21 98 ex 2204 22 93 ex 2204 22 94 ex 2204 22 95 ex 2204 22 96 ex 2204 22 97 ex 2204 22 98 ex 2204 29 93 ex 2204 29 94 ex 2204 29 95 ex 2204 29 96 ex 2204 29 97 ex 2204 29 98	Vera nga rrushi i freskët, me një forcë alkoolike për vëllim që nuk tejkalon 15% vëllim, ndryshe nga vera e gazuar	681 hl	Lirimi nga detyrimet

³ Pavarësisht rregullave për interpretimin e Nomenklaturës së Kombinuar, formulimi për përshkrimin e produkteve konsiderohet të jetë vetëm tregues, dhe skema preferenciale përcaktohet, brenda kontekstit të këtij aneksi, nga mbulimi i kodeve CN. Kur tregohen kodet CN të kaluara, skema preferenciale përcaktohet nga aplikimi i kombinuar i kodit CN dhe përshkrimi përkatës.